

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 91,
subjekti ankues Partia Lëvizja e Legalitetit”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. E. Mema.

Të tjerë: KRIIK.

Z. I. Rusmali: Dakord, riçelim seancën përgatitore për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 91, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Levizja e Legalitetit. Në seancën e fundit i dhamë subjektit 24 orë afat për ta plotësuar dhe korigjuar kërkesën ankimore. Subjekti nuk është paraqitur sot në seancë, administrata e KQZ-së konfirmon që nuk ka bërë as plotësimin dhe korigjimin.

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk e ka bërë.

Z. I. Rusmali: Dakord, Sekretari i Përgjithshëm konfirmon se nuk është depozituar plotësimi dhe korigjimi sipas porosive të KAS-it i kërkesës ankimore, ë këto kushte, besoj, Sekretari i Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaj: Kërkojmë mospranim, moskalimin e kërkesës për shqyrtim.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Rusmali: Kolegë, atëhere KAS-i i konsultuar në vend vendos moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore për shkak të mosplotësimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes sikurse i kërkon kodi zgjedhor. Më kaq e mbyllim këtë seancë.

Vendimi nr. 162

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

30.05.2023

Ora 14:33

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 87, subjekti ankues
Partia Social Demokrate e Shqipërisë”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. E. Mema.

Të tjerë: KRIIK.

Z. E. Lako: Mirë, çelim seancën e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për të shqyrtuar në vijim kërkesën ankimore numër 87, të paraqitur nga ankuesi Partia Social Demokrate e Shqipërisë, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 540, datë 20.05.2023. edhe për këtë çështje KAS-i i la 24 orë afat ankuesit, për të plotësuar kërkesën sipas kërkesave ligjore me provat, me saktësimet e objektit dhe me pretendimet përkatëse në funksion të kërkit. Deri më sot në orën 14:33, njoftohemi nga administrata që nuk ka asnjë kërkesë në lidhje me këtë çështje. Apo jo zoti Merkaj?

Z. Y. Merkaj: Po, Partia Social Demokrate pikërisht në afatin 24 orë nuk ka plotësuar kërkesën e cila është kthyer për plotësim. Faleminderit!

Z. E. Lako: Mirë, meqënëse ka kaluar afati 24 orë dhe ankuesi nuk e ka plotësuar kërkesat e ligjit dhe çfarë u la në seancën tjetër, KAS e konstaton këtë fakt dhe i konsultuar në vend vendos moskalimin e kësaj çështje për shqyrtim, për shkak të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

mosplotësimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës ankimore. Me
kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë. Ju faleminderit!

Vendimi nr. 163

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 88,
subjekti ankues Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.**

PJESËMARRJA :

**KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.**

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. E Mema.

Parti Politike: PDIU (Sh. Sulo, K.Xhemali)

Z. L. Braho: Mirë atëhere, përshëndetje! Çelim seancën e shqyrtimit të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës ankimore numër 88, me ankues subjektin zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, shkurt PDIU, me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit të KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë, dhe pika 2, ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë për këshillat bashkiak. Numër vendimi nuk ka, ankimi është depozituar në datë 25.05.2023, relator i kërkesës ankimore me short, hedhur nga KQZ-ja jam caktuar unë, anëtari Ledio Braho, janë të pranishëm dhe tre anëtarë të tjerë të KAS-it, pra korumi për zhvillimin e kësaj séance plotësohet, të pranishëm janë përfaqësuesit e PDIU-së, subjektit zgjedhor PDIU, po ashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Atëhere a ka një kërkesë paraprake nga palët? Dakord, zoti Merkaj shkurtimisht në lidhje me elementët e formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë ankimore.

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Y. Merhaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 88, ankues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Lezhë. Nga verifikimi paraprak i elementëve formal të kërkesës konstatohet se nuk i plotëson elementët e kërkuar nga neni 126, i Kodit Zgjedhor, duke mbajtur dhe standartin e mbledhjes së mëparëshme, duke qënë se kërkesa është e arsyetuar në mënyrë të përgjithshme pa e përcaktuar kush janë pravat dhe faktet që kërkon të meren në shqyrtim administrativ, i kërkojmë KAS-it ta kthejë kërkesën për plotësim duke i lënë 24 orë kohë palës ankuese të tregoj përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar faktet dhe provat të cilat kërkohen të merren gjatë shqyrtimit administrativ. Në këto kushte i kërkojmë KAS kthimin duke i lënë 24 orë kohë palës ankuese. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, ju folët për fakte dhe për prova por unë shoh që si në objektin e ankimit dhe bashkalidhur ankimit janë vendimet e KZAZ-ve, Bashkia Lezhë ka më shumë se një KZAZ?

Z. Y. Merhaj: Po Bashkia Lezhë ka dy KZAZ.

Z. L. Braho: Rezultati miratohet nga Komisioneri me vendim.

Z. Y. Merhaj: Rezultati miratohet nga Komisioneri, tabela përmbledhëse nuk është miratuar akoma.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. L. Braho: Pra nuk është miratuar akoma. Mirë, faleminderit! Fjala për përfaqësuesin e subjektit zgjedhor i cili të relatojë në lidhje me pretendimet e Sekretarit të Përgjithshëm, të na qartësojë në lidhje me vendimin objekt ankimimi, janë vendimet e KZAZ-së apo janë ndonjë vendim tjetër.

Z. Sh. Sulo: Faleminderit i nderuar relator, të nderuar anëtar të KAS-it, PDIU-ja është drejtuar me këtë kërkesë ankimore duke kundërshtuar vendimin e KQZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë, miratuar në datën 23.05.2023, po për arsye ne nuk i kemi vendosur numrin e vendimit, ose më saktë është 545, ku nëpërmjet kësaj ankese ne kërkojmë rinumërimin e KZAZ-së 12 dhe KZAZ-së numër 13, si dhe pasqyrimin e votave në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve Bashkia Lezhë, për zgjedhjet e oraganeve të qeverisjes vendore datë 14.05.2023. Nga ato që ne kemi parë në dy tabelat e KZAZ-ve, KZAZ-së 12 dhe 13, në Bashkinë Lezhë, ka rezultuar që subjekti PDIU ka marr 284 vota në një KZAZ dhe 225 vota në KZAZ-në tjetër. Ajo që nga njoftimet që ne kemi nga përfaqësuesit tanë ka rezultuar që brenda tre orëve në KZAZ-të si 12 dhe 13 janë ndërruar 4 herë grupet e numërimit, një veprim në kundërshtim të plotë me ligjin, pasi e përcakton fare qartë sesa kuti numërojnë ose sa orë mund të numëroj një grup numërim. Ajo që na bie në sy nga tabelat e miratuara në KZAZ-të 12 dhe 13, shikohet që subjekti PDIU, keni tabelën aty, vetëm në 16 Qendra rezulton që ka marr vetëm 3 vota. Ndërsa po të shikosh po në këtë KZAZ është përfaqësues i cili ka qënë kandidat i këshillit bashkiak dhe ne kemi të deklaruar mbi 50 persona, minimalisht do ishin raportuar jo tre por pesë ose shtatë përshembull, por jo tre. Ndërsa Qendrat e tjera ka 30 vota e te tjera, e të tjera me rradhë. Këto shkelje të konstatuara në referim të nenit 160, pika 1, të Kodit Zgjedhor, të ndodhura në këtë Qendër Votimi kanë cënuar procesin zgjedhor në masë të tillë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

që kanë ndikuar edhe përsa i përket anëtarëve të këshillit bashkiak në Lezhë, pasi mandatet janë marr në masën prej 520 votash, PDIU kishte 510 vota. Në kërkojmë i nderuar relator rinumërimin e fletëve të votimit, KAS, KZAZ-së numër 12 dhe 13 dhe pasqyrimin në bazë të numërimit të tyre ndryshimit pasqyrën e tyre në tabelat përmbledhëse Lezhë. Ne kemi paraqitur tabelat përmbledhëse të rezultateve KZAZ numer 12 dhe KZAZ numër 13, po dhe vendimin, miratimin nga Komisioneri të kësaj Bashkie, kemi marr para dy ditësh me anë të kërkesës të vënë në dispozicion me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm kemi marr pamjet filmike përsa i përket dy KZAZ-ve,12, 13 po dihet që ato kanë kohën e nevojshme të tyre për t'i parë, dhe ne do të kërkonim meqënëse u deklarua që do të vijë vendimi i KZAZ-së për miratimin e vendimeve numër 545 datë 23.05.2023, dhe mendojmë të nderuar anëtarë që me rinumërimin e tyre që të ketë një ndryshim të rezultatit, një shmangie e tyre, dhe kërkojmë që këto të merren në konsideratë nga ana juaj. Mendojmë që është në formën e plotë ankesa dhe jo siç u paraqit nga përfaqësuesit e KQZ-së. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit avokat. Tani me çfarë kuptoj unë ju bëtë një kërkesë për të ndryshuar objektin e ankimit dhe kundërshtimin e vendimit numër 545, datë 23.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Këtu jemi dakord.

Z. Sh. Sulo: Përsa i përket këshillave bashkiak të Bashkisë Lezhë, kadnivatëve të këshillave bashkiak të Bashkisë Lezhë. Ky është numri i vendimit për këshillin.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj, ky është numri i vendimit për këshillin Bashkiak Lezhë, 545?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. L. Braho: Mirë na vini në dispozicion dhe vendimin që ta kemi, se pala ka bashkalidhur vendimin e KZAZ-së. Tani ju keni marr vendimin apo jo?

Z. Sh. Sulo: Po i nderuar relator, ne i kemi marr filmimet dhe normalisht për të ndihmuar dhe KQZ-në për ngarkesën që ka, ndoshta ne krijojmë dhe vet besimin tonë, ne kemi hapur deri tani 9 kuti të cilat me një fjalë, ne kemi shpresa dhe prandaj i mëshojmë këtij ankimi që mund të kemi ndryshim të kësaj.

Z. L. Braho: Po në këto 9 kuti?

Z. Sh. Sulo: Ka ndryshime, ka ndryshime dhe ne i kemi paraqitur i kemi fotokopjuar dhe fletët e votimit, me orë me të gjitha gjërat siç janë dhe në pamjet filmike.

Z. L. Braho: Ju keni patur numërues në këto KZAZ besoj?

Z. Sh. Sulo: Po, kemi patur numërues.

Z. L. Braho: Po kjo historia e ndërrimit të numëruesëve si e keni.

Z. Sh. Sulo: Përfaqësuesi jonë thotë që nga KZAZ-ja 12, 13, ndodhi një fenomen i cuditshëm, që brenda 4 orëve janë ndërruar 4 herë grupet e numërimit.

Z. L. Braho: Anëtarët e numërimit të partive të tjera jo të PDIU-së?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Të gjitha jo vetëm të PDIU-së, të gjithë. Pra nqs unë do të isha në Qendër të Votimit, duhet të isha 3 orë në një tavolinë siç e përcakton ligji, unë jam ndërruar çdo 20 minuta, çdo gjysmë ore. Kjo është ajo që pretendojmë ne.

Z. L. Braho: Dakord, ndonjë nga kolegët.

Z. Sh. Sulo: Nëse më lejohet të bëj një kërkesë, për t'i ardhur në ndihmë KQZ-së, KAS-it, për ngarkesën që ka, të na japi kohën e mjaftueshme të parashikuar në ligj, që ne

Z. L. Braho: Sa mendoni ju, ju duhet kohë për të kqyrur filmimet.

Z. Sh. Sulo: Varet, 3-4 ditë se tre veta kemi ne, se

Z. L. Braho: Ne do ju lëmë afatin maksimal që na lejon Kodi.

Z. Sh. Sulo: Dakord, afatin maksimal.

Z. L. Braho: Atëhere për shkak të ngarkesës me seanca të parashikuara tashmë që kanë kaluar në shqyrtim administrativ, nëqoftë se nuk e respektojmë dot afatin jo më herët se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë, seancën për kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 88, me ankues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 545, datë 23.05.2023, për ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve zgjedhore, Bashkia Lezhë, për këshillin bashkiak. Seanca për shqyrtimin

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

administrativ e kësaj kërkesë ankimore, do të caktohet ditën e premte, më datë 2 qershor, në orën 10.00. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 164

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 92, subjekti ankues Partia
Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. E. Mema.

Parti Politike: PDIU (Sh. Sulo, K. Xhemali)

Z. E. Çefa: Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore numër 92, të datës 27 maj 2023, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, me inicialet PDIU, me objekt kundërshimitin vendimit të KQZ-së të tabelës përmbledhëse me rezultatet e zonës zgjedhore Bashkia Librazhd, ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Librazhd, për këshillin bashkiak. Sipas shortit të hedhur ditën e djeshme relator i kësaj çështje jam unë anëtari Elvis Çefa, verifikojmë fillimisht prezencën, është prezent trupa e KAS-it në përbërje prej katër anëtarësh, anëtari Beke për arsye objektive e ka të pamundur të paraqitet në këtë seancë, por kjo nuk pengon KAS-in që të vazhdoj shqyrtimin e kësaj kërkesë, normalisht për shkak se korumi konsiderohet. Plotësuar. Është prezent përfaqësuesi i ankimuesit, ju lutem prezantohuni me mikrofon.

Përfaqësuesi: Sulo.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Sulo, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Pa humbur kohë për të na dhënë opinionin e tij lidhur me elementët e formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë ankimore, ja jap fjalën zotit Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 92, me ankues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Librazhd. Nga verifikimi paraprak i kërkesës, ashtu si dhe të kërkesa e parë, konstatohet se i mungojnë elementët e parashikuar në neni 126, të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht përshkrimi i shkurtër i shkeljes, përshkrimi i fakteve, argumentave dhe dispozitave ligjor në të cilat mbështetet ankimi, si dhe tregimi i provave të cilat tregohen gjatë shqyrtimit të procesit administrativ. Në këto kushte duke mbajtur të njëjtn qëndrim i kërkojmë KAS-it kthimin e kërkesës për plotësim, duke i lënë palës ankuese afat 24 orë për të sjellë provat të cilat kërkon të merren gjatë këtij shqyrtimi administrativ. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Merkaj, atëhere ja jap fjalën përfaqësuesit të palës ankuese për të sqaruar problematikat që u evidentuan nga administrata, nga Sekretari i Përgjithshëm.

Z. Sh. Sulo: Po, faleminderit i nderuar zoti relator, ne i jemi drejtuar KAS-it me kërkesën ankimore përse i përket kundërshtimit të vendimit të KQZ-së për miratim të tabelës përmbledhëse të zonës zgjedhore Bashkia Librazhd, ndryshimit të tabelës përmbledhëse përse i përket kandidatëve për këshillin bashkiak. Ka rezultuar në

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

KZAZ-në numër 52, ku subjekti zgjedhor PDIU ka qënë regjistruar në këto zgjedhje vendore, përse i përket kandidatit për këshillin bashkiak rezulton se ky subjekt ka marr 227 vota në total. Problematikat të cilat ne i kemi hasur në këtë KZAZ, ka qënë që në momentin e numërimit të votave nga ana e anëtarëve të grupeve të numërimit nuk shqiptohet me zë të lartë pasqyrimi i votave , një veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin. Po të shohësh dhe kamerat e Qendrave të Votimit konstatohet se kemi një tjetërsim të vullnetit të votava nga ato të deklaruara me gojë nga numëruesi në ato të hedhura në sistem. Në tabelë të rezultatit të këshillit bashkiak shikohet një fenomen i cuditshëm, se në 17 Qendra Votimi që kisIU kishte vetëm 1 votë, ku në këto Qendra, siç kemi të dhënat tona, kemi 10 mbështetës të deklaruar, ndërsa në Qendra të tjera ka dhe 37 vota PDIU dhe të tjera. Në këto kushte ne do të kërkonim, më fl, do të kërkonim, ndjesë se është bërë një gabim aty, do të kërkonim rinumërimin e fletëve të votimit në KZAZ numër 52, Librazhd, dhe më pas psqyrimin e tyre. Provat që paraqiten është tabela përmbledhëse e rezultateve të zgjedhjeve për këshillin bashkiak, Librazhd, të KZAZ-së numër 52, kërkojmë vendimin e KQZ-së për miratimin e tabelave, të merret si provë nga KQZ-ja, burim saj është për miratimin e tabelës përmbledhëse rezultati zgjedhor kandidati i këshillit bashkiak për Bashkinë Librazhd. Pamjet filmike i nderuar zoti relator ne i kemi marr dje mos gabohem, për Librazhdin, dhe kemi të njëjtën situatë si të lezhës, që jemi duke i punuar vet për t'i krijuar dhe vet njëfarë opinionin, që a do t'i qëndrojmë kërkesës, a ka tjetërsime, por nga informacionet që ne kemi nga përfaqësuesit tanë në Librazhd, mendohet se ka një tjetërsim të votës. Në këto kushte ne do kërkonim pranitim e kërkesë padisë ankimore përse i përket KZAZ-së numër 52.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Dakord, do doja të dija nëse jeni në gjendje të caktoni tani në seancë numrin e vendimit të KQZ-së të cilin ankimoni, nuk e di nëse e keni? Nuk e keni as numrin? Vendimi i KQZ-së apo është i KZAZ-së, 589.

Z. Sh. Sulo: Ne tërhiqemi dhe qëndrojmë me atë sqarimin që bëri Sekretari i Përgjithshëm, faleminderit.

Z. E. Çefa: Pra saktësimin e objektit të ankimit duke kundërshtuar vendimin e KZAZ-së numër 52, Bashkia Librazhd, pra kundërshtimin e vendimit 529, datë 24 maj 2023, 589 më falni, datë 24 maj 2023, 16 atëhere se këtu është 24 data në kërkesë ankimore, dakord. Ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Sekretari i Përgjithshëm në komentin e vet referoi te provat të cilat duhet t'i bashkëlidheshin kësaj kërkesë ankimore, dhe ju thoni që jeni ende duke i grumbulluar këto prova, besoj jeni i vetëdijshëm për faktin që kur ne të çelim seancën e shqyrtimit në themel provat duhet të jenë të gjitha në dispozicion, sepse çdo vendim që ne marrim e marrim mbi bazën e provave. Kërkesa juaj për rinumërim sot nuk ka asnjë kuptim. Ju kundërshtoni vlerësimin a vendimin e tabelën, kërkonti ndryshimin e tabelës, por ndryshimi i tabelës dhe verifikimi i provave nga ne bëhet kur ju të sillni provat nga pamjet filmike, kështu që të jeni të vetëdijshëm për këtë fakt, nëqoftëse merrni tre ditë kohë do t'i merrni që të na sillni provat ne, jo të na sillni vëzhgimet e vëzhguesëve.

Z. Sh. Sulo: Po, patjetër.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 92, të datës 27.05.2023, me subjekt ankues Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Seanca e themelit do të zhvillohet ditën e premte, datë 2 qershor, në orën 10:30. Kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 165

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 78, subjekti ankues
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.**

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. E. Mema.

Parti Politike: PDIU (Sh. Sulo, K. Xhemali)

Të tjerë: KRIIK.

Z. E. Çefa: Mirëdita dhe njëherë deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore numër 78, të datës 22 maj 2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, me objekt ankimi kundërshtimin e tabelës së rezultateve për Qendrën e Votimit numër 32,39/00, të GNV-së numër 1, datë 16.05.2023, të KZAZ-së numër 62, Mallakastër. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e KAS-it në përbërje të cileve janë katër anëtarë, fakt që nuk e pengon KAS-in të vijojë shqyrtimin e kësaj kërkesë, për arsye se korumi konsiderohet i plotësuar. Është prezent pala ankuese përfaqësuar nga

Përfaqësuesit: Shkëlqim Sulo dhe Klajdi Xhemali.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit, është prezent edhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Atëhere shkurtimisht duke qënë se jemi në gjykimin e themelit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

do t'i japim fjalën ankuesit që të parashtojë arsyen dhe provat ku e mbështet ankimin e tij. Për ju fjala avokat.

Z. Sh. Sulo: Faleminderit i nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë të KAS-it, siç është diskutuar dhe në seancën paraprake, ka rezultuar që në KZAZ-në numër 52, Mallakastër, në momentin e numërimit të votave, Grupi i Numërimit të Votave pozicionuar në tavolinën numër 1, të Qendrës së Votimit 32/29, nga lodhja në përlllogarinë e tyre i ka hedhur në sistem gabimisht votat duke ja kaluar një subjekti tjetër, nga ato që duhet t'i kalonte subjektit PDIU. Nga ky kalim Pdiu ka humbur një mandat, dhe nga prava që është kërkuar dhe nga ana juaj, është miratuar dhe nga ana KAS-it, ka rezultuar që nga pamjet filmike në këtë KZAZ, në këtë Qendër Votimi, ka rezultuar që 56 fleta votimi, të cilat ne i kemi filmuar me orë, me minuta dhe me datë të printuara janë të cituara nga, janë të hedhura për subjektin PDIU. 56. Prandaj këto i vëmë në dispozicion të anëtarëve të KAS-it, çka konfirmon dhe një herë dhe shqetësimin nëpërmjet kërkesës së bërë në KZAZ-ja numër 62, Mallakastër, si nga titullari i KZAZ-së i cili i ka dërguar një shkresë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të bërë këtë ndryshim. Vendosim në dispozicion fletët e votimit të cilat janë të printuara me orë, me minuta dhe me datë , për Qendrën e Votimit të cilën e përcaktuam, faleminderit.

Z. E. Çefa: Po ju faleminderit.

Z. Sh. Sulo: Në këto kushte kërkojmë që të hapen kutitë e votimit dhe këto numra të pasqyrohen në ndryshimin e saj.

Z. E. Çefa: Këto fletë votimi i keni nga pamjet filmike?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Sh. Sulo: Atëhere nga pamjet filmike të cilat na u vunë në dispozicion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm, ne i pamë në selinë tonë dhe i printuam të gjitha ato fleta votim, të gjitha sesa ishin dhe normalisht të printuara.

Z. E. Çefa: Po, dakord, faleminderit. Atëhere shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm, na sqaroni pak edhe lidhur me kutin që kemi prezent këtu, për efekt të procesverbalit.

Z. Y. Merkaç: Duke qënë se është kërkuar dhe nga ankuesi që në këtë Qendër Votimi numri i votave të PDIU-së rezulton me zero vota, për Qendrën e Votimit 32/39, mendojmë ë nuk është një gabim njerëzor nga ana e KZAZ-ve, Grupeve të Numërimit, pasi janë shpërndarja e votave nëqoftëse është kështu nuk është bërë gabim që votat e një subjekti janë kaluar një subjekti tjetër, por këto janë shpërndarë në gjithë subjektet, unë e kuptoj 56 vota nuk ka asnjë subjekt që ka 56 vota siç pretendon pala, megjithatë ne e kemi sjellë duke qënë se ka sjellë provat, të bëhet rinumërimi, të shohim, për të kuadruar por puna është që duhet ta shohim, të hapim kutinë pastaj të shohim.

Z. E. Çefa: Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi pranimin dhe administrimin si provë të dokumenteve, pra të printimeve nga pamjet filmike për kutinë e votimit numër 32,39/00, të KZAZ-së numër 62, paraqitur nga ankuesi, po ashtu KAS-i vendosi kqyrjen e provës, duke, pra nëpërmjet hapjes së kutisë së votimit dhe identifikimit të votave të subjektit PDIU që ndodhen në këtë kuti votimi. Ju lutem

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

administrata të organizojë punën përse më sipër. 5 minuta pushim ndërkohë, e pezullojmë sa të rifillojmë edhe njëhërë kqyrjen. Faleminderit.

Atëhere riçelim seancën aty ku e lamë, administrata është gati tashmë për të filluar procesin e hapjes së kutive të votimit. Vazhdoni ju lutem.

Z. B. Kodra: Hapim kutinë e Qendrës së Votimit me numër 32 39/00 e cila është e mbyllur me kodet 008724.

Z. A. Losha: Konfirmohet!

Z. B. Kodra: 008722

Z. A. Losha: Konfirmohet!

Z. B. Kodra: 008728

Z. A. Losha: Konfirmohet!

Z. B. Kodra: 008727

Z. A. Losha: Konfirmohet!

Z. B. Kodra: Dhe kodi i pestë 137233

Z. A. Losha: Konfirmohet!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. B. Kodra: Atëhere, kemi zarfin PD plus PDIU. Në këtë kuti votimi ka procesverbali 06 i kodeve të sigurisë që është mbyllur kutia dhe procesverbali 08 për mbylljen e qendrës së votimit. Duhet të jetë edhe raporti PEI i zgjedhësve që kanë votuar. Numri i zgjedhësve 720...

Z. I. Rusmali: Nuk ka nevojë!

Z. B. Kodra: Dakord! Të fillojmë me votat e pavlefshme apo me...?

Z. I. Rusmali: Do kontrollosh a ka për PDIU-në!

Z. B. Kodra: Ka një zarf që thotë subjekti zgjedhor PD plus PDIU. Po e hapim në fillim këtë zarf. Janë dy blloqe, blloku i parë është i votave të Partisë Demokratike, po kontrollojmë nëse ka për PDIU-në këtu. Të gjitha këto votat ishin në favor të subjektit Partia Demokratike.

Z. E. Çefa: Ndërkohë, grupi i votave që keni tani është për PDIU-në?

Z. B. Kodra: Tani është për PDIU-në.

Z. E. Çefa: Dakord, do të vijoni që ti numëroni dhe sa vota janë sepse sipas tabelës përmbledhëse rezulton që të ketë 0 (zero) vota në kuti për PDIU-në. Pra fakti që ato janë të gjitha të grupuara bashkë besoj që u evidentua dhe pretendimi i ankuesit domethënë, kështu që numërojini edhe votat sa janë në total.

Z. B. Kodra: Dakord! 63 (gjashtëdhjetë e tre)!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Pra 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë votimit për subjektin zgjedhor PDIU. Të gjitha janë të rregullta. Dakord! Tani do të hapim edhe zarfin tjetër!

Z. B. Kodra: Janë 6 (gjashtë) vota të pavlefshme.

Z. E. Çefa: 6 (gjashtë) vota të pavlefshme!

Z. B. Kodra: Këtu është subjekti zgjedhor BF, PAA, PKSH, PR, ALD.

Z. E. Çefa: I votimit të kujt subjekti janë ato që po numëroni tani? Po ju pyes për tufën që keni në dorë!

Z. B. Kodra: Bashkë fitojmë.

Z. E. Çefa: Dakord, vazhdoni!

Z. B. Kodra: Këto ishin të gjitha vota në favor të subjektit zgjedhor BF.

Z. E. Çefa: Tek votat e BF-së nuk ka asnje votë për PDIU-në. Dakord!

Z. B. Kodra: Po shohim edhe te PAA-së, Partia Agrare Ambientaliste. Nuk ka! Tek votat e PKSH, nuk ka. Tek PR-ja, nuk ka. ALD, nuk ka. PUK, nuk ka edhe këtu asnjë votë. Subjekti zgjedhor PSD. Edhe tek ky subjekt nuk ka! Subjekti zgjedhor PDS, nuk ka. LZHK, nuk ka. FRD-ja, nuk ka. AD-ja, nuk ka. Është edhe një zarf i subjektit zgjedhor PS, po e hapim edhe këtë. Tek subjekti PS nuk ka PDIU!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Atëherë, votat e secilit subjekt na i numëroni edhe njëherë ju lutem!

Z. B. Kodra: PS-ja ka 97 (nëntëdhjetë e shtatë).

Z. E. Çefa: Përveç PDIU-së që e fiksuam ka 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota të vlefshme në kuti. PS, 97 (nëntëdhjetë e shtatë).

Z. L. Braho: Këtu ka 161 në tabelë!

Z. E. Çefa: PS, 97 (nëntëdhjetë e shtatë). Plus 63? Bukur, vazhdojmë! Subjekt tjetër çfarë ka? PAA, e keni aty? E keni lehtësisht të dallueshme?

Z. B. Kodra: Meqë e kemi ketu PD-në. 25 (njëzet e pesë).

Z. E. Çefa: 25 (njëzet e pesë). Vazhdojmë!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor AD, numri rendor 14 (katërmëdhjetë) ka 4 (katër) vota.

Z. E. Çefa: 4 (katër), në rregull, aq!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor FRD, 1 (një) votë.

Z. E. Çefa: Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor LZHK, 2 (dy) vota.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor PDS, ka 3 (tre) vota.

Z. E. Çefa: Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor PS (me numër rendor 8) ka 7 (shtatë) vota.
Subjekti zgjedhor PUK (me numër rendor 22) ka 6 (gjashtë) vota.

Z. E. Çefa: Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor ALD (me numër rendor 7) ka 1 (një) votë.

Z. E. Çefa: Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor PR (me numër rendor 4) ka 2 (dy) vota.

Z. E. Çefa: 2 (dy) vota, po. Në rregull!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor PKSH (me numër rendor 32) ka 1 (një) votë.

Z. E. Çefa: Po!

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor PAA (me numër rendor 3) ka 4 (katër) vota.

Z. E. Çefa: Në rregull!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. B. Kodra: Subjekti zgjedhor BF ka 23 (njëzet e tre) vota.

Z. E. Çefa: 23 (njëzet e tre), aq sa ishin. Dakord!

Z. L. Braho: Do të numëroni edhe njëherë, PS dhe PDIU-në.

Z. B. Kodra: 63 (gjashtëdhjetë e tre) ka PDIU-ja, aq sa ishin! PS ka 98 (nëntëdhjetë e tetë) vota!

Z. E. Çefa: Atëherë, administrata merr masa që të mbylli edhe njëherë kutinë pas...
ndërkohë që zoti Sekretar i përgjithshëm plotëson tabelën e re. Ne jemi gati për të kaluar në konkluzionet përfundimtare. Ju vazhdoni!
Avokat, përfunsimisht, çfarë kërkon?

Z. Sh. Sulo: Kërkojmë pranimin e ankesës, pasqyrimin e këtyre votave të dala nga numërimi në tabelën përfundimtare për Kandidat për Këshillin e Bashkisë Mallakastër, rrjedhimisht dheniën e mandatit Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Z. E. Çefa: Dakord!

Z. B. Kodra: Atëherë, kutia e qendrës 3239/00 mbyllet me kodet e sigurisë 089642, 089641, 089645 dhe 089643, kaq, mjaftojnë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm meqënëse jemi në konkluzione!?

Z. Y. Merkaç: Po! Atëherë kërkojmë pranimin e kërkesës sipas rezultatit të dalë nga grupi i numërimit.

Z. E. Çefa: Faleminderit! KAS i konsultuar në vend vendosi:

- Pranimin e kërkesës ankimore me numër 78 datë 22.05.2023 të subjektit Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.
- Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për këshillin bashkiak për kutinë e votimit numër 3239/00 sipas rezultatit të ri të dale nga rinumërimi ku subjekti PDIU nga 0 (zero) do të ketë 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota dhe subjekti Partia Socialiste e shqipërisë nga 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) vota do të ketë 98 (nëntëdhjetë e tetë) vota. Për pjesën tjetër tabela nuk ndryshon.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqeb zyrtare të KQZ-së.
- Kundrejt këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur!

Vendimi nr. 166

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimin e kërkesës numër 89, subjekti ankues: Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Meta, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PDIU (Z. Sh. Sulo, Z. K. Xhemali)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirdita edhe njëherë, deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore me numër 89 të datës 25 maj 2023 me subjekt ankimues subjektin zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet me inicialet PDIU. Me objekt kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, duhet të jetë e KZAZ-së besoj? S’ka problem, po e sqarojmë! Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore Bashkia Delvinë, ndryshimin e kësaj tablele përmbledhëse të rezultateve për keshillat bashkiak. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e KAS-it në përbërje të së cilës janë katër anëtarë, për arsye objektive anëtari Bele nuk mund të paraqitet në këtë seancë por ky fakt nuk e pengon KAS-in që të vijojmë me shqyrtimin e kërkesës për shkak se kurumi konsiderohet i përmbushur. Është prezent përfaqësuesi i palës ankuese.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Shkëlqim Sulo dhe Klardi Xhemali.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Çefa: Faleminderit. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Pa humbur kohë ja jap fjalën përfaqësuesit të palës ankimuese për të parashtruar shkurtimisht edhe njëherë fakte, rrethanat dhe argumentat e tij lidhur me këtë kërkesë ankimore. Fjala për ju avokat!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: I nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zgjedhjet vendore të 14 majit në Bashkinë Delvinë ka garuar përsa i përket kandidatëve për këshillin bashkiak. Duke parë tabelën përmbledhëse të rezultateve përsa i përket këshillit bashkiak rezulton që PDIU ka marrë 245 (dyqind e dyzet e pesë) vota kur ka rezultuar që në monitorët e institucionit të KQZ-së apo edhe në median e shkruar dhe të folur, deri në orët e vona, ku pasqyroheshin live rezultatet nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dilte që Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet kishte 1 (një) mandat për këshillat bashkiak në Bashkinë e Delvinës. Çuditërisht në miratimin e tabelës përfundimtare rezulton që nuk kishte asnjë mandat dhe po të vësh tabelën përfundimtare përsa i përket kandidatëve rezulton që një subjekt tjetër dhe konkretisht PSD i cili ka marrë 753 (shtatëqind e pesëdhjetë e tre) vota ka marrë 3 (tri) mandate. Ndërsa PDIU me 245 (dyqind e dyzet e pesë) vota nuk ka marrë asnjë mandat. Ne do të kërkonim duke ju referuar nenit 162 të Kodit Zgjedhor përlllogaritjen e këtyre mandateve në raport me votat e marra përsa i përket kësaj bashkie. Prandaj do të kërkonim nga ana e KQZ-së nëse është e mundur të na bëjnë një përlllogaritje me anë të specialistëve të saj apo çfarë mendimi...

Z. E. Çefa: Në seancë paraprake ju la detyrë që draftin tuaj të përlllogaritjes, ta bëni ju vetë përlllogaritjen dhe sipas jush sa mandate ju takojnë sipas llogaritjes dhe ne pastaj e verifikojmë, pra administrata e verifikon nëse është bërë ose jo saktë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Po keni të drejtë, por për disa arsytet e mia personale nuk kam qenë fare në Tiranë edhe kolegu, nuk e kemi bërë këtë gjë. Nëse është e mundur që KAS-i mendon të na japë një ndihmë, përfaqësuesit e KQZ-së, do t'ju falënderonim.

Z. E. Çefa: Zoti sekretar i Përgjithshëm.

Z. Y. Merkaç: Po, atëherë për Bashkinë e Delvinës është marrë vendimi nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 556 datë 23.05.2023, i cili ka bërë shpërndarjen e mandateve nëpërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e Bashkisë Delvinë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Llogaritja është bërë sipas nenit 162 të Kodit Zgjedhor pika 1 dhe 4 e tij, ku janë vendosur, janë renditur të gjitha partitë që kanë marrë numrin e votave të vlefshme të gjitha subjektet zgjedhore, 13 subjekte zgjedhore që kanë kandiduar për këshillin e Bashkisë Delvinë, është zbatuar formula, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numrat natyrorë të njëpasnjëshëm të quajtur pjesëtues, duke filluar nga numri 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15, që i korrespondon numrit të mandateve të shpërndara në zonën zgjedhore të Bashkisë së Delvinës, në bazë të shkresës së prefektit të Qarkut të Vlorës. Sipas nenin 162 pika 4 e Kodit Zgjedhor herësin e përfutuar për çdo pjesëtim renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël duke renditur përkrah tyre subjektin, i cili i përket herësit përkatës. Renditja vazhdon deri sa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore, pra 15. Nga kjo renditje kemi marrë rezultatin i cili fillon herësi i parë, është Partia Socialiste ka 2025 vota, Partisë Socialiste prapë herësi i dytë me 1012 vota

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

“Bashkë Fitojmë” me 804 vota, Partia Socialdemokrate me 753 vota, mandati i gjashët është Partia Socialiste me 675, mandati i 7 është i Partisë Socialiste me 506 vota, mandati tjetër është i Partisë Demokratike me 416 vota, mandati i tjetër i Partisë Socialiste me 405 vota, “Bashkë Fitojmë” me 402, mandati 10 është Partia Socialdemokrate me 376, vota Partia Socialiste me 337 vota ka mandatin e 11, Partia socialiste me 289 vota ka mandatin 12, partia “Bashkë Fitojmë” me 268 vota ka mandatin 13, Partia socialiste ka mandatin e 14 me 253 vota dhe Partia Socialdemokrate ka mandatin e fundit me 251 vota. Ashtu siç e tha dhe pala ankuese ka marrë 225 vota, pra nën numrin e kësaj, që mendojmë që KQZ-ja ka zbatuar Kodin Zgjedhor, sipas formulës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Mendojmë që e kemi bërë drejt. Nuk e di nëse pala ankuese ka ndonjë pretendim për këtë llogari që kemi bërë ne.

Z. E. Çefa: Faleminderit! A ka pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Nuk ka.

Z. E. Çefa: Avokati?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: I nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë, duke treguar edhe një herë performancën tonë si forcë politike në tërhiqemi nga ky ankim. Jemi dakord me sqarimin e bërë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.

Z. E. Çefa: Faleminderit juve! Atëherë, në këtë pikë nuk ka nevojë për të vijuar më tepër. KAS-i i konsultuar në vend vendosi pranimin e kërkesës për tërheqjen nga

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

ankimi dhe pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore me numër 89, datë 25 maj 2023, me subjekt Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shfaqet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 167

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

**30.05.2023
Ora 16:14**

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 71, subjekti ankues: “Bindja Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:**
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore numër 71, ankuesi: “Bindja Demokratike”, me objekt: numërimin e kutive të këshillit bashkiak për Bashkinë e Tropojës, përkatësisht kutitë 0522, 0473, 0476 dhe vijuese; pika 2, ndryshimi tabelave përmbledhëse të KZAZ-së Tropojë. KAS-i është me përbërje të plotë, gjithashtu, prezent është administrata e KQZ-së me sekretarin e Përgjithshëm. Palë të tjera prezentë që kanë lidhje me këtë, a kemi? Jo, nuk ka. Në këtë fazë nuk ka kërkitime paraprake, apo deklarime. Kështu, që Ylli, vetëm objektin se hyrjen e bëra unë.

Z. Y. Merkaj: Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se nuk i plotëson elementete formale pasi referuar nenit 126 të Kodit Zgjedhor i mungojnë provat bashkëlidhur kërkesës, gjithashtu, vetë ankuesi ka shtuar: Sipas nenit 136 të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Zgjedhor, ka të drejtë të marrë provat dy anëtarë të KAS-it. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it ta kthejë për plotësim duke lënë një afat 24 orë, për të plotësuar provat që mbështesin pretendimet e saj. Faleminderit!

Z. K. Bele: Pra ai ka thënë që, nëse i lind në zemër dy anëtarëve të KAS-it të hapin kutitë..

Z. Y. Merkaj: Te faqja e dytë, thotë që sipas nenit 136.

Z. K. Bele: A ka pyetje?

Z. E. Çefa: Zoti Merkaj, pra pavarësisht kërimit që ka bërë subjekti, a e ka shoqëruar të paktën me ndonjë indicie kërkesën e vet, në mënyrë që eventualisht nëse dy anëtarë duan ta marrin nismën të kenë ndonjë indicie?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk ka.

Z. K. Bele: Pala nuk është prezentë, nuk është munduar të arsyetojë, nuk ka bërë një fillim për prova, a ka dijeni?

Z. Y. Merkaj: Patjetër ka dijeni, është njoftuar për seancën e sotme.

Z. K. Bele: Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend, duke pasur parasysh dhe praktikën e deritanishme, si dhe kërkesën e sekretarit të Përgjithshëm, i jep 24 orë kohë për të plotësuar të metat e kërkesës ankimore me numër 71, si afat është afati për ditën

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

e nesërme ora 14:30. Deri në atë kohë është afati i mjaftueshëm për palën të plotësojë nëse ka të tilla. Seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 168

*Zbardhi materialin aullio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

**30.05.2023
Ora 16.19**

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 90, subjekti ankues koalicioni
“Bashkë Fitojmë”, kundër vendimit numër 545, datë 23.05.2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”

Z. K. Bele: Çelim seancën lidhur me kërkesën ankimore numër 90, datë 26.05.2023, të kërkuarit “Bashkë Fitojmë” me objekt ndryshimin e vendimit të KSHZ, numër 545, datë 23.05.2023, për vendimin për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kryetar bashkie dhe këshillin bashkiak zona zgjedhore Bashkia e Lezhës. Ne relatojmë se kësaj kërkesë i është lënë afat 24 orë për të plotësuar provat, pasi në seancën e parë nuk ka pasur prova sipas Kodit Zgjedhor dhe Kodit të Procedurave Administrative. A keni ndonjë mendim?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se në seancën e djeshme datë 29 05.2023 në orën 11:00, i është kthyer kërkesa për plotësimin e kërkesës dhe brenda afatit sot të orës 13:00 nuk është plotësuar kërkesa kërkojmë moskalimin e kërkesës në seancë dhe rrëzimin e saj.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. K. Bele: Në këtë seancë a ka pasur avokat prezent?

(Diskutime pa mikrofon)


Ka qenë vetë personi?

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, përfaqësuesi nuk ka treguar interes për të marrë pjesë si dhe nuk është plotësuar kërkesa e caktuar nga KAS-i në seancën paraparake. Në këto kushte, KAS-i i konsultuar në vend vendos moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore. Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda afatit 5 ditor në Kolegjin Zgjedhor. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.169

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

**30.05.2023
Ora 16.21**

RENDI I DITËS

**Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 76, subjekti ankues: Koalicioni
“Bashkë Fitojmë”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. E. Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti politike:** BF (F. Nuri, I. Kaso), PS(M. Legisi, E. Salianji)
- **Të tjerë:** KRIIK, përfaqësuesi i Bashkisë Belsh, kandidati i BF (B.Qypi)

Z. L. Braho: Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 76, me ankues subjektin zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” me objekt ankimimi kundërshtimin e vendimit numër 533 datë 18.5 2023, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë së Belshit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14. maj 2023; rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të të gjithë qendrave të votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, duke u përfshirë në këtë rezultat të dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave; pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në qendrën e votimit numër 2565/01 EVP, Burgu Kosovë, në zonën zgjedhore Bashkia Belsh; ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatin për kryetar bashkie, Bashkia Belsh duke mos përfshirë rezultatit e kësaj qendre votimi, si dhe shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar bashkie për Bashkinë Belsh të zotit Bedri Qypi. KAS-i ka vendosur në seancën e kaluar që ka qënë për elementet e formës dhe përmbajtjes

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

ka vendosur kalimin e kësaj kërkesë ankimore për shqyrtim administrativ ditën e sotme. Të pranishëm janë përfaqësuesit dhe ankuesit koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
Ju lutem prezantohuni!

Z. F. Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. I. Kaso: Ivi Kaso, me autorizim numër 487 të protokollit datë 30.05.2023, për këtë çështje dhe për një çështje tjetër.

Z. L. Braho: Faleminderit! Po ashtu të pranishëm janë edhe përfaqësues të subjektit të palës së interesuar të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Z. E. Salianj: Eridian Salianji dhe zoti Marenglen Legisi.

Z. M. Legisi: Përfaqësues me autorizim.


Z. L. Braho: Faleminderit! Po ashtu i pranishëm është edhe sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së që është në çdo seancë tjetër. Atëherë a ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët në lidhje me trupën e KAS-it, apo kërkesa të tjera paraprake?

Z. F. Nuri: Jo.

Z. E. Salianji: Jo.

Z. L. Braho: Nuk kemi kërkesa. Atëherë, vijojmë, fjala për përfaqësuesit të ankuesit përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në lidhje me pretendimet që keni për këtë kërkesë ankimore.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. F. Nuri: Atëherë, në zonën zgjedhore të Bashkisë Belsh siç jeni në dijeni ka marrë pjesë në votime 9260 votues, saktësisht. Numërimi është kryer në datat 15 dhe 16 maj, për kryetarin e bashkisë. Dhe nga ky proces, gjatë të cilit në si subjekt zgjedhor kemi konstatuar parregullsi, megjithatë KZAZ-ja numër 45 që ka të bëjë me Bashkinë e Belshit nuk arriti të dalë me vendim, sikundër të gjithë e dimë. Kemi vendimin për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë së Belshit nga KZAZ-ja 45, qarku Elbasan, më datë 17.05.2023, është nënshkruar nga 4 anëtarë, nga 7 gjithsej, të cilët e kundërshtojnë këtë tabelë përmbledhëse. Nisur nga ky fakt, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Celibashi, ka marrë vendimin për miratimin e tabelave përmbledhëse dhe ne jemi këtu, sepse e kundërshtojmë këtë vendim të Komisionerit. Kemi paraqitur kërkesat për të marrë kamerat dhe për të këqyrur kamerat e një numri të caktuar qendrash votimi, kemi kërkuar, gjithashtu, informacionet në rrugë zyrtare te Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhe institucione të tjera. Në lidhje me vendimin, objekt ankimi, rezulton se është shpallur fitues kandidati Arif Tafani, i mbështetur nga Partia Socialiste me 4537 vota, ndërkohë që kandidati ynë që është prezent sot zoti Bedri Qypi, i mbështetur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka marrë zyrtarisht sipas KQZ-së 4497 vota, saktësisht 40 vota më pak. Nga të dhënat në tabelat e rezultatit rezulton se diferenca është disa herë më e vogël se vetë numri i vetë fletëve të pavlefshme në të gjithë bashkinë e Belshit, i cili ishte 229, sipas shifrave zyrtare. Ne kemi qenë të bindur që ka pasur parregullsi, në të gjithë zonat e Bashkisë së Belshit dhe kemi kërkuar siç e thamë edhe një herë marrjen dhe këqyrjen e kamerave. Kamerat na janë vënë në dispozicion dhe nga këqyrja e këtyre ne kemi arritur të përpilojmë një tabelë me të dhëna dhe indicie ku figurojnë të paktën 60 fletë votimi për kryetarin e Bashkisë së Belshit, mund t’i rendis dhe qendrat e votimit një për një, ku ne gjykojmë se në të gjitha këto ka devijim të votës dhe vota nuk ka shkuar aty ku duhej. Atëherë,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

po e nisim në KZAZ-në 45 të Belshit, qendra e votimit 2551. Kemi evidentuar nga këqyrja e kamerave dy vota të përlllogaritura në rezultatin final, të cilat gjenden në kutinë e veçantë të dorëzuar në KQZ, dhe votat janë në favor të kandidatit tonë dhe nuk janë llogaritur.

Z. L. Braho: Më falni, çfarë do të thotë kuti e veçantë?

Z. F. Nuri: Të materialeve zgjedhore.

Z. L. Braho: Pra dy fletë votimi janë në kutinë e materialeve zgjedhore, jo në kutinë e fletëve?

Z. F. Nuri: Po. Që janë plotësisht të vlefshme.

Z. B. Qypi: Grupi i Numërimit i gjeti poshtë kamerës dhe Komisioni i parë...

Z. F. Nuri: Qendra e votimit 2551. Viojmë më tej me qendrën e votimit 2551? 1 ku ka një votë me shkronjën a, te kutia përbri kandidatit të Partisë Socialiste, në vend të shenjës kryq ose iks që është shenja zyrtare për të votuar rregullisht, është germa a, dhe kjo votë është quajtur e vlefshme. Në qendrën e votimit 2552 kemi evidentuar dy vota të pavlefshme, të cilat i kanë shkuar kandidatit të Partisë Socialiste, njëra me numrin 1 dhe tjetra në kuti me siglën PS, edhe këto vota janë quajtur të vlefshme. Në qendrën e votimit 2553 kandidati i PS-së ka 4 vota të pavlefshme në vlerësimin tonë, të cilat janë vlerësuar të vlefshme nga grupet e numërimit. Viojmë me qendrën 255 ku kandidati i Partisë Socialiste ka dy vota të pavlefshme në gjykimin tonë, të cilat janë të identifikueshme, në qendrën 2556 janë 5 vota për kandidatine

*Zbardhi materialin/audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Partisë Socialiste më shenja të identifikueshme, në qendrën 2559 janë 4 vota, në qendrën 2560, kemi 1 votë me shenjë identifikuese në qendrën 2562 janë 2 vota. Gjithsej për grupseksionin e Belshit ne i kemi ndarë me grup seksione, kemi evidentuar 23 vota që nuk aknë shkuar sipas vullnetit të zgjedhësve apo shumica e votave kanë qenë të pavlefshme dhe janë konsideruar të vlefshme.

Z. L. Braho: Pra grup seksione i referoheni këtyre qendrave që sapo cituat. Pra, në këto qendra janë 23 vota.

Z. F. Nuri: Gjithsej 23 vota. Ne i kemi dhe me shkrim dhe mund t'i depozitojmë për saktësi. Gjithsesi kemi ende disa qendra të tjera. Në zonën e Fierzës, po themi, në qendrën e votimit 2564 kemi evidentuar 7 vota, në të cilat njëra nga vulat nuk është e dallueshme, të cilat janë në favor të kandidatit tonë zotit Bedri Qypi dhe janë vlerësuar të pavlefshme nga grupet e numërimit. Në qendër e votimit 2565 ka 4 vota të cilat të cilat njëra nga vulat nuk është e dallueshme të cilat janë në favor të kandidatit tonë, gjithashtu, të Koalicionit Bashkë Fitojmë dhe janë vlerësuar të pavlefshme nga grupe t numërimit. Gjithashtu, në qendrën e votimit 2566 është një votë për kandidatin e Partisë Socialiste me shenjë dalluese, votë, e cila është vlerësuar e vlefshme ndërkohë që duhej të ishte e pavlefshme. Në total 12 vota me probleme te këto qendra votimi të zonës së Fierzës. Në zonën e Grekanit qendra e votimit 2569, kemi evidentuar 6 vota me shenja dalluese për kandidatin e Partisë Socialiste, pra me shenja dalluese identifikuese. Në qendrën e votimit 2570 janë tri vota për kandidatin e Partisë Socialiste, gjithashtu, me shenja dalluese, në qendrën e votimit 2571, 2 vota për kandidatin e Partisë Socialiste me shenja dalluese, në qendrën e votimit 2572, 3 vota, po ashtu me shenja dalluese. Në total për grupseksionin Grekan për zonën Grekan janë 14 vota me probleme. Në zonën e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

grupseksionit Kajan janë qendrat e votimit njësia administrative Kajan, janë gjithsej 6 vota në total me probleme, 2 në qendrën e votimit 2575, 3 vota në qendrën e votimit 2580 dhe 1 votë për kandidatin e Partisë Socialiste me shenjë dalluese në qendrën e votimit 2582 e të tjera me radhë. Së fundi, në njësinë administrative Ras janë 5 vota me problematika, janë përkatësisht në qendrën e votimit 2586, 4 vota për kandidatin e Partisë Socialiste me shenja dalluese, që janë vlerësuar të vlefshme dhe 1 votë në qendrën e votimit 2587, gjithashtu, për kandidatin e PS-së votë me shenjë dalluese që normalisht duhej të ishte e pavlefshme. Në total janë 60 vota. Nëse mundem t'jua vë në dispozicion këtë tabelë që ne kemi arritur të elaburojmë nisur nga këqyrja e kamerave të vëna në dispozicion vetëm para 3 ditësh nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Z. L. Braho: Kam edhe një pyetje, ju i keni këqyrrur të gjitha qendrat e votimit, pra e keni këqyrrur të gjithë materialin filmik, që ju është dhënë nga KQZ-ja?

Z. B. Qypi: Po i kemi parë pamjet filmike për të gjitha qendrat dhe te këto qendra ka fiksuar këto defektet që ne mendojmë këto vota janë të pavlefshme.

Z. L. Braho: Sa qendra votimi ka gjithsej Bashkia Belsh?

Z. B. Qypi: 40.

Z. L. Braho: Faleminderit!

Z. F. Nuri: Atëherë, në shtesë të kësaj ne kemi evidentuar edhe problematika të tjera gjatë procesit të votimit sikundër ishte mungesa e pajisjes PEI, edhe

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

problematika të ndryshme, por dëshirojmë të tërheqim vëmendjen edhe për rastin e IVP –së, pra të burgut të Kosovës, ose i quajtur ndryshe burgu i Lushnjës, që çuditërisht llogaritet në Bashkinë e Belshit për shkak të ndarjes administrative territoriale, ku afërsisht rezultati ishte 100% në favor të kandidatit të Partisë Socialiste, i cili e bënte të dyshimtë votimin, por nuk ishte vetëm aty problemi. Probleme, në gjykimin tonë, ka pasur që në krye të herës për faktin se me shkresën datë 25.03.2023 të KZAZ-së 45 Belsh, është ky vendim këtu, vendimi nr. 3 datë 25.03.2023, mbi ngritjen e qendrës së votimit 25-61/1 që ka të bëjë pikërisht me IVP përkatëse, të shtatë anëtarët e KZAZ-së kanë refuzuar që ta ngrenë këtë qendër votimi, mbështetur në verifikimet e të dhënave në këtë institucion, ku kanë konstatuar se nuk ka banorë të Bashkisë së Belshit dhe historikisht nuk kanë votuar në zgjedhjet vendore, dhe nisur nga sa më sipër i kanë propozuar KQZ-së që kjo qendër votimi të mos ngrihet në këtë institucion. Më vonë pastaj kemi vendimin e Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili ka vendosur që ta ngrejë këtë qendër votimi vetëm 2 ditë para zgjedhjeve.

Z. L. Braho: E kemi këtë shkresën ne? Ke prova bashkëlidhura me ankimin, apo është provë e re?

Z. F. Nuri: Kjo është që e depozitojmë sot, por është material zgjedhor, duhet ta ketë KQZ-ja. Ka ardhur në rrugë zyrtare, patjetër se është vendim i KZAZ-së, dhe është i datës 25 mars 2023, pavarësisht kësaj kjo qendër është ngritur.

Z. L. Braho: Dhe pastaj si është ngritur kjo qendër?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. F. Nuri: Me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të datës 12, që i bie të premtën. Është vendimi nr. 501 për krijimin e KQV –së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 25-61/1 KZAZ nr. 45 Bashkia e Belshit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Vendimi ishte nr. 501, është marrë të premtën në datën 12 maj, ora 12:00, dhe Komisioneri ka marrë shkas nga disa vendime që kanë ardhur nga gjykata për lejime për të votuar të burgosurit.

Z. L. Braho: Me 12 maj është krijuar qendra e votimit?

Z. F. Nuri: 12 maj, 2 ditë para zgjedhjeve, ishte dita e fundit e fushatës zgjedhore,

Z. L. Braho: Ylli, na i vër në dispozicion të dyja këto dhe atë të KZAZ-së dhe vendimin e Komisionerit për ngritjen e kësaj KQV-je .

Z. F. Nuri: Dëshëm të shtojmë gjithashtu se në atë qendër nuk ka patur as kamera dhe as aparati PEI nuk ka qenë prezent dhe nuk ka funksionuar ose nuk ka pasur fare, për verifikimin e votuesve në këtë IEVP, pra në burgun e Kosovës nuk ka funksionuar, nuk ka ekzistuar. Pra, është edhe problematika e burgut, le të themi, në rastin konkret sikundër mund ta sqarojë edhe kolegu Kaso,

Z. L. Braho: Po, zoti Kaso, fjala për ju.

Z. I. Kaso: Përshëndetje! Faleminderit! Për të vazhduar atje ku e la kolegu, ashtu siç është relatuar dhe në pjesën ankimore, por edhe në 2 dokumente të rëndësishme që parashtrroi përpara KAS-it dhe ju i kërkuat që të dalin nga arkivi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe t'u vendosen në dispozicion, problematika në qendrën e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

posaçme në I EVP, që tradicionalisht quhet burgu Kosovë Lushnje, po që në fakt krijon pasoja në rezultatin zgjedhor dhe në tabelën përfundimtare të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh, nuk ka lindur ditët e fundit të zgjedhjeve, përkundrazi ka lindur në një moment kohor mjaft të arsyeshëm, në një moment kohor kur KZAZ-ja, krahas verifikimeve përkatëse që ajo bënte, siç e parashikon ligji, në raport me zgjedhësit që duhet të votojnë, në raport me qendrat e votimit që ngrihen në këtë zonë zgjedhore, në një moment përpara daljes së listës përfundimtare të zgjedhësve ka verifikuar edhe atë çka duhet të ishte lista, në qoftë se do të kishte një të tillë, paraprahe deri në atë moment, që synohej të bëhej finale në datën 4 prill, të zgjedhësve që mund të votonin në këtë I EVP, dhe në raport me mënyrën sesi e kupton ligjin jo vetëm ligjin zgjedhor, por dhe detyrimet që burojnë nga ligjet e tjera, Kodi Civil, ligji për gjendjen civile, mënyrën sesi e ka kuptuar KZAZ-ja, i ka referuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që në këtë I EVP, në këtë zonë zgjedhore, që mund të ngrihej në teori një qendër e posaçme për të votuar, nuk ka asnjë zgjedhës që mund ta ushtrojë të drejtën e votës, pasi në këtë institucion të vuajtjes së dënimit nuk ka asnjë banor, relatton KZAZ-ja, të Bashkisë Belsh, pra asnjë banor të cilit i lind, sipas ligjit, e drejta për të votuar në këtë zonë zgjedhore dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme dhe i rekomandon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të mos ngrejë një qendër votimi të posaçme në këtë institucion të vuajtjes dhe dënimit. Çfarë ndodh? Ndodh që krejt papritur, jashtë vullnetit edhe të administruesve zgjedhorë, edhe të administruesve më të lartë zgjedhorë, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në këtë rast, është administrata e burgut ajo që merr një rol proaktiv, dhe nëpërmjet juristit të burgut vendos që t'u realizojë të dënuarve, pavarësisht kishin ose jo të drejtë që të votonin në këtë zonë zgjedhore, t'u realizojë të drejtën e votës. Për këtë arsye juristi i burgut, i paraqitur me autorizim të posaçëm nga 24 shtetas, të cilët vuajnë dënimin në këtë I EVP, paraqitet në

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

gjykatën e Elbasanit, dhe midis datave 10 dhe 12, pra vetëm 4 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, deri në 2 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, merr 24 vendime gjyqësore për lejimin e këtyre shtetasve për të votuar, dhe e vë në njëfarë mënyre Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përpara faktit të kryer, që ka një masë kritike zgjedhësish të cilët, për pamundësi të shoqërimit dhe të bërjes efektive të së drejtës së tyre të votimit në këtë zonë zgjedhore, në një qendër tjetër duhet ngritur qendra e posaçme. Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vetëm 2 ditë përpara ose 36 orë përpara momentit të zgjedhjeve, është thjesht një reflektim i një situatë të prodhuar kryesisht nga administrata e burgut. Pretendimi që ngremë ne, që e kemi elaboruar në kërkesën që kemi paraqitur përpara jush, në formën e pavlefshmërisë, por siç do të ndalemi në sqarimin me gojë të saj përpara KAS-it, sepse kemi arritur që ta elaburojmë akoma më tej, pasi kemi marrë informacione të cilat nuk i dispononim në momentin që është hartuar kërkesa ankimore, ka të bëjë, në radhë të parë, me faktin që administrata vetë, e burgut në radhë të parë, ashtu sikundër bëri KZAZ-ja, që është niveli i dytë i administrimit zgjedhor, dhe më i rëndësishmi nga pikëpamja e përgatitjeve zgjedhore dhe e menaxhimit ditës së votimit, derisa futet në lojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe organet e të tjera ankimore, pra, atë verifikim dhe atë kujdes minimal, që e kishte patur KZAZ-ja duhet ta kishte patur minimalisht administrata e burgjeve, minimalisht gjykata dhe më pas, në mënyrë të reflektuar, ndoshta Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në qoftë se do ta kishte shqyrtuar këtë çështje, në një kohë të arsyeshme, që lidhet me faktin dhe pyetjen thelbësore, që këta shtetas, të cilëve u është garantuar e drejta e votimit në IEVP, në kushte të caktuara, përfitojnë nga e drejta e votës në atë zonë zgjedhore për këto lloj zgjedhjesh, pasi kujtojmë që çështja e ushtrimit të drejtës së votës, veçanërisht për shtetas të cilët, për shkak të kryerjes së shërbimit ushtarak ose vuajtjes së një dënimi penal ose rrethanave të tjera, nuk është e pakushtëzuar, por ligjvënësi, në një mënyrë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

shumë skematike, e ka përcaktuar qartë në ligjet e tjera, të cilat rregullojnë çështje të rëndësishme që lidhen me raportin e zgjedhësve, me ushtrimin e drejtës së votës, siç është, për shembull, elementi thelbësor që Kodi Zgjedhor e ka në vëmendje në momentin që përcakton vendin se ku duhet të votojnë të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, pra që është elementi më i rëndësishëm, që është ai vendbanimit. Pra, minimalisht gjykata, administrata e burgut dhe kushdo tjetër duhet të kishin patur kujdesin për të verifikuar në qoftë se vendbanimi i këtyre shtetasve ishte vërtet institucioni i vuajtjes së dënimit penal, sikundër e ka marrë të mirëqenë gjykata, që i ka lejuar këta shtetas të votojnë apo jo. Në këndvështrimin tonë dhe në atë çka kemi mundur që të sigurojmë, këta shtetas nuk e kanë patur asnjëri në momentin që u është bërë “efektive e drejta” e tyre për të votuar për këto lloj zgjedhjesh, pra për zgjedhjet e pushtetit lokal, asnjëri prej tyre nuk e ka patur vendbanimin në Bashkinë e Belshit. Rrjedhimisht përse kjo, në radhë të parë? Në radhë të parë, sepse këtë konstatim e bën KZAZ –ja me vendim të shoqëruar me firmat e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së, që qartazi pasqyrojnë të gjitha flukset dhe krahët politikë, të cilët balancohen dhe menaxhohen së bashku procesin zgjedhor. Pra, në një moment të pangarkuar nga ethet e rezultatit, të pangarkuar nga fakti që na leverdis apo nuk na leverdis këta shtetas të votojnë, niveli i dytë i administrimit zgjedhor, të majtë e të djathtë së bashku, kanë vlerësuar që nuk ka asnjë shtetas në këtë institucion të vuajtjes së dënimit që ta ketë vendbanimin në atë moment Bashkia Belsh. Çfarë do të thotë kjo? Na referon më pas te pyetja, që është thelbi i këtij diskutimi dhe i kësaj shkeljeje, siç do të vërtetojmë që është materializuar më vonë, tek ajo çka është vendbanimi dhe si përcaktohet kjo në ligjet përkatëse. Atëherë, Kodi Zgjedhor parashikon, dhe e lidh nocionin e vendbanimit veçanërisht për sa u përket këtyre llojeve të zgjedhjeve, në nenin 165, ku parashikon se kryetarët e bashkive, si dhe të këshillave bashkiakë zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

bashkisë. Pra, na del për herë të parë nocioni i vendbanimit dhe zgjedhësit të cilët për këto lloj zgjedhjesh të posaçme duhet ta kenë vendbanimin jo kudo, por në territorin e asaj njësie për të cilën votojnë. Gjithashtu, Kodi Civil përcakton në nenin 12 se banimi është vendi ku personi për shkak të punës ose të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta qëndron zakonisht ose në të shumtën e kohës. Ndërkohë që neni 14 na paraqit edhe rastin e shtetasve, të cilët për një arsye ose një tjetër ndodhen larg vendbanimit të tyre, duke përcaktuar konceptin e vendqëndrimit të personit dhe duke sqaruar që vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal dhe raste të tjera të kësaj natyre. Pra, qartazi shtetasit, të cilët janë duke vuajtur një dënim penal në një institucion të vuajtjes së dënimit, në atë institucion, sipas nenit 14 të Kodit Civil, kanë vendqëndrimin dhe jo vendbanimin. Gjykata këtë element të rëndësishëm në të 24 vendimet, që ka lëshuar në kohë rekord për një ditë e gjysmë, dhe është për të përgëzuar që ka lëshuar në një kohë rekord 24 vendime, nuk e ka analizuar në asnjë moment të vetëm dhe nuk e ka përmendur në asnjë moment të vetëm, por, duke iu referuar në mënyrë të gabuar nenit 57 të Kodit Zgjedhor, arsyeton se këta shtetas, të cilët për një arsye ose për një tjetër nuk e gjejnë emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve, dhe s'kishte si ta gjenin, sepse nuk kishin vendbanimin në këtë zonë zgjedhore, duhet të lejohen të votojnë atje ku ata kishin kërkuar nëpërmjet juristit të burgut, që të votonin, pra pikërisht në këtë institucion, i cili nuk ishte ngritur akoma, po që duhet të ngrihej më pas. Dhe në kundërshtim nga çfarë merr të mirëqenë dhe në mënyrë automatike gjykata, pra, në interpretim të nenit 57, ku ndalet vetëm në paragrafin e parë dhe atë duke e keq interpretuar, më lejoni t'ju referoj paragrafin e parë, pasi lidhet përsëri me një koncept tjetër të rëndësishëm, dhe paragrafi i parë me vendbanimin. Ligji parashikon


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

se kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës qendres së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësive së qeverisjes vendore, ku ai ka vendbanimin (përsëri kujdeset legjislatori në çdo fjali e rikujton që duhet vendbanimi dhe jo vendqëndrimi), përsëri gjykata, duke bërë konfuzion të këtyre 2 nocioneve, vendbanimi dhe vendqëndrimi, u jep të drejtë atyre zgjedhësve, në një kohë kur zgjidhja normale logjike dhe ligjore duhet të ishte referimi te paragrafi 2, i po të njëjtës dispozitë, kur jemi në rastet kur zgjedhësit ndryshon vendbanimin me kërkesën e tyre ose me atë çka mendojnë ata se është vendbanimi, pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon, thotë legjislatori, dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit, ku ka emrin në listën e miratuar. Në këtë rast, në rast se zgjedhësi paraqet kërkesën në gjykatë, në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet. Pra, të gjitha kërkesat, të 24 kërkesat duhet të ishin rrëzuar. Gjykata, në mënyrë të gabuar, në këndvështrimin tim, e ka referuar, në përgjithësi një pjesë e gjyqtarëve pasi janë 2, 3 gjyqtarë të ndryshëm, nga 24 vendimet gjyqësore të cilat kanë lejuar këta shtetas të votojnë në këtë zonë, me ushtrimin ose me nevojën për t'u bërë efektivë dhe aktive të drejtën për të zgjedhur këtyre shtetasve, në një kohë që nuk merr fare parasysh, sikundër e marrin parasysh gjykata të tjera, po në raste analoge, të investuara me të njëjtat shqetësime dhe që presupozohet në mbrojtje të njëjtave të drejta dhe lirive të dënuarve të tjerë, nuk i referohet një vendimmarrje shumë të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje. Konkretisht, vendimi nr. 40 datë 16.11.2007 i Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se, megjithatë drejta e votës nuk është absolute dhe ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Dhe duke ju referuar zgjedhjeve, të cilat ne sapo i lamë pas, pra procesin zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, vazhdon elaberon Gjykata e Kushtetuese këto nocione. Një nga dallimet mes këtyre dispozitave është se për zgjedhësit për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

lidhur ushtrimin e drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar te fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është dhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jazonën zgjedhore kur ai votohet për të gjithë zgjedhësit. Ndryshe, thotë, Gjykata Kushtetuese ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimi parashkollor, pastrimi, gjelbërimi, mjediset e njësisë së qeverisjes vendore etj, etj. Kushti për të patur vendbanimin, vazhdon Gjykata Kushtetuese, në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte qoftë edhe minimale midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar. Ajo që ka ndodhur në rastin e zgjedhësve të cilët janë lejuar të votojnë në IEVP e Bashkisë së Belshit është krejt e kundërta. Pra, mungon ajo lidhje qoftë indirekt, qoftë direkt, qoftë edhe minimale, që thotë Gjykata Kushtetuese midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, pasi kemi të bëjmë me votues të cilët e kanë ushtruar të drejtën e votës, në radhë të parë, në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit të Kodit Civil, ligjit zgjedhor, por mbi të gjitha që u mungon edhe interesi për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, pasi ende në momentin të cilën flasim 24 zgjedhës nuk e kanë vendbanimin në atë zonë. Kjo, i nderuar, është një shkelje e rëndë që ka ndodhur në këtë qendër votimi, pra, në qendrën e posaçme të ngritur me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në Bashkinë e Belshit, e cila vërejmë që nuk ka ndodhur në të njëjtën mënyrë në zonat e tjera, në të cilat po

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

gjkata është investuar me të njëjtën problematikë. Kujtojmë që kemi një rast analog, një vendim, të paktën, që më ka rënë në dorë, i gjykatës së Tiranës për çështjen civile me nr. 52 akti, datë 4.05.2023. Pra, edhe ky vendim për këto zgjedhje, kur gjykata, në mënyrë korrekte, e investuar për të njëjtën problematikë nga një zgjedhës F.G, i cili kërkonte që të votonte si i paraburgosur në IEVP-në “Jordan Misja” nr. 313, kërkonte ta ushtronte këtë të drejtë të votës në institucionin e posaçëm, pra, në qendrën e votimit të posaçme, të ngritur pranë këtij institucioni, gjykata ia mohon pikërisht me të njëjtat arsye, duke referuar, në radhë të parë, dispozitat urdhëruese të Kodit Zgjedhor dhe më pas të cilat lidhin të drejtat e votës jo vetëm për zgjedhjet, po veçanërisht për këto lloj zgjedhjesh, me konceptin e vendbanimit, por mbi të gjitha duke referuar drejt te parashikimet e nenit 57 të Kodit Zgjedhor, pra te paragrafi i dytë i tij, kur zgjedhësit të cilët nuk kanë vendbanim në një zonë të caktuar, kërkojnë që të votojnë në një në zonë, pavarësisht se nuk e kanë vendbanimin, gjykata mund të marrë veçse një vendim, që e ka imponuar legjislatori në paragrafin e dytë dhe ai mendim është refuzimi i kërkesës, siç ka bërë, me të drejtë, gjykata e Tiranës dhe duke cituar në pjesën arsyetuese po të njëjtën vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese, pra vendimin nr. 40 datë 16.11.2007, i cili qartazi e ndan këtë çështje se kush mund të votojë për zgjedhjet e pushtetit lokal dhe kush nuk mundet të votojë. U ndala pak gjatë, sepse është çështje, e cila jo vetëm, të paktën në dijeninë time, nuk ka marrë një përgjigje shteruese nga institucionet të cilat administrohen dhe japin përgjigje për problematikat që lindin gjatë procesit zgjedhor, si KQZ-ja që ka qenë më përpara, tani me formatin e ri, siç është KAS-i pjesë e KQZ-së, siç është Kolegji Zgjedhor, pra nuk ka një vendimmarrje përfundimtare, e cila ta ndajë këtë çështje sesi duhet të sillen, por edhe duke vërejtur e mbledhur ne si subjekt zgjedhor problematikat që na vijnë nga cepa të ndryshëm të Shqipërisë, në të cilat është manifestuar e njëjta problematikë dhe i njëjti zell i


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

administratës së burgjeve për të ushtruar shtetasit, që vuajnë një dënim penal në institucionet e vuajtjes së dënimit penal, në mënyrë efektive e të menjëhershme të drejtën e votës, veçanërisht për këto zgjedhje, kemi parë që trajtimi që është bërë nga gjykatat, por qoftë edhe nga vetë institucionet e vuajtjes së dënimit penal, ka qenë i natyrave të ndryshme, prandaj do të ishte e udhës që kjo çështje, qoftë edhe nëpërmjet këtij ankimi me të cilin është investuar sot KAS-i ose ankimeve të tjera të kësaj natyre, të merrte një përgjigje përfundimtare dhe shteruese në qoftë se ajo çfarë thotë Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjen e saj ende në fuqi sot, ajo çfarë thotë legjislatori në të gjitha nenet e Kodit Zgjedhor, që të drejtën e zgjedhësit për të ushtruar të drejtën e votës në mënyrë efektive e lidh me konceptimin e vendbanimit, duhet të interpretohet dhe të zbatohet në një proces zgjedhor ashtu siç është shkruar nga legjislatori apo ashtu siç e dikton interesi dhe vullneti i pushtetit, i cili kontrollon qartazi edhe gjithë administratën e burgjeve dhe e dikton gjithë aksionin e tyre të orientuar qartazi drejt interesit politik, sikundër mund të shihet qartazi edhe nga përfundimi që jo vetëm rezultati zgjedhor ka prodhuar në këtë IEVP të posaçme të Bashkisë Belsh, por në të gjitha IEVP-të e Republikës së Shqipërisë, ku të gjithë shtetasit, që vuajnë dënimet penale, janë qartazi aq të kënaqur me kushtet, me trajtimet dhe me gjithçka tjetër, sa në masën 100% kanë votuar qartazi kandidatin e maxhorancës. Kështu që do të ishte e udhës që KAS-i ta ndante përfundimisht këtë çështje. Për të bërë një përmbledhje shkurtimisht, shkeljet e evidentuara dhe të paraqitura në kërkesën tonë ndahen në dy kategori të mëdha: shkelje të cilat kanë ndodhur përgjatë procesit të numërimit dhe tabulimit të rezultatit zgjedhor, ku mjaft vota të pavlefshme për kandidatin rival të kandidatit përfaqësues të subjektit tonë zgjedhor, si kërkues janë tabuluar ose, në radhë të parë, votuar si të vlefshme nga numëruesit në radhë të parë, ose nga KZAZ-ja e thirrur në atë moment, por mjaft prej tyre janë vota qartazi të identifikueshme duke shkelur atë çfarë përcakton Kodi

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*


Zgjedhor, që vota duhet të jetë, e përcakton Kushtetuta në radhë të parë, por Kodi Zgjedhor bën detajimin të mënyrës, të shenjave dhe të karakteristikave që duhet të ketë një fletë votimi për të qenë e vlefshme dhe për t'u tabuluar si e tillë. Pra, këto ishin në kategorinë e parë të shkeljeve, të cilat i evidentoi kolegu Nuri. Kategoria e dytë e shkeljeve, grupimi më i madh ka të bëjë me shkeljet, të cilat kanë ndodhur gjatë procesit të votimit, por të nisura shumë më herët, pra që në momentin e "hartimit" të një liste zgjedhësish, kur kjo zonë zgjedhore, kur kjo qendër e posaçme nuk kishte një listë të tillë të miratuar me listën përfundimtare të zgjedhësve dhe më pas lejimi për të votuar i 24 shtetasve, të cilët nuk mund ta kishin këtë të drejtë në këtë zonë zgjedhore. Këto janë pak a shumë të përmbajtura në kërkesë.

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Kaso, për shpjegimet shteruese! Fjala për përfaqësuesin e palës së interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Z. E. Saliانji: Faleminderit! Para se të filloj me prapësimet, doja të bëja dy pyetje dhe pastaj të shteroj prapësimet. Pyetja e parë është për administratën: qendra e votimit e burgut të Kosovës ka qenë në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2019? Në qoftë se nuk dini, ju lë kohë të bëni verifikimet. Së dyti, në momentin e vendimit të KAS-it për ngritjen e kësaj qendre votimi, ka pasur ankesa pranë institucionit të KQZ-së për refuzimin e ngritjes së kësaj qendre ose ankim kundër ngritjes së kësaj qendre, ndaj vendimit të Komisionerit? Me sa dimë, ne kemi qenë prezentë ditën e premte këtu dhe na është njoftuar kjo vendimmarrje, ka qenë edhe publike, por nuk e di nga subjekte të tjera a ka pasur ankim. Edhe kjo pyetje është për administratën.

Z. L. Braho: Po, zoti Merkaj, kërkoni kohë, apo mund të përgjigjeni?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.30.05.2023

Z. Y. Merkaj: Për pyetjen e parë kërkojmë kohë të verifikojmë nëse ka qenë apo jo si qendër votimi në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2019. Për pyetjen e dytë ndaj vendimit të Komisionerit nr. 501, datë 12.5.2023 nuk është bërë ankim, vendim i cili ka vendosur të krijohet një qendër votimi e posaçme në burgun e Lushnjës.

Z. E. Saliانji: Pyetja e tretë. Në dijeninë tuaj, meqenëse aty nuk ka pasur sistem PEI, me sa anëtarë ka qenë e kompozuar qendra e votimit? Kanë qenë edhe të pozitës e të opozitës në këtë qendër votimi?

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se nuk ka pasur as PEI, as kamera, sepse kjo qendër votimi është krijuar dy ditë para zgjedhjeve dhe nuk ishin planifikuar as kamerat, as pajisja PEI. Komisioni ka qenë i përbërë nga 7 veta sipas përbërjes, me anëtarë të pozitës dhe të opozitës.

Z. E. Saliانji: Faleminderit!

Z. L. Braho: Po thoni që kanë qenë 7 anëtarë. Jo sa ka Kodi, sa kanë qenë të pranishëm aty.

Z. Y. Merkaj: Këtë do ta verifikojmë tani.

Z. L. Braho: Verifikojeni edhe këtë që të na rakordojnë numrat. Vazhdoni, zoti Saliانji.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*


Z. E. Salianji: Për sa i përket relatimit të pjesë së parë, në lidhje me gjetjen e shkeljeve në numërim, që u relatua nga ankuesi, kisha një pyetje për ankuesin: në grupet e numërimit keni qenë të përfaqësuar me numërues?

Z. I. Kaso: Unë besoj që nuk duhet t'ia shpjegoj unë vendimmarrjen. Jo vetëm parashikimet e Kodit Zgjedhor, por mënyra si harton grupet e numërimit, por edhe vendimmarrjen e posaçme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet KAS-it lidhur me të drejtën e përfaqësimit të përfaqësuesve të subjektit zgjedhor koalicionit “Bashkë Fitojmë” në tavolinat e numërimit. Ka një vendimmarrje të KAS-it, të lënë në fuqi me një vendim të Kolegjit Zgjedhor lidhur me faktin që numëruesi i katërt në gjysmat e tavolinave të numërimit, pra në çdo vend numërimi votash do t'i përkiste subjektit zgjedhor, koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Në mos gaboj, në tavolinat me numrat tek, pra në gjysmat e tavolinave të numërimit subjekti ynë, rrjedhimisht edhe kandidati ynë ka pasur 1 numërues nga 4, ndërkohë në gjysmat e tavolinave të tjera ka pasur zero numërues nga katër.

Z. E. Salianji: Nga vëzhguesit tuaj dhe numëruesit, ata që keni pasur, si dhe nga vendimmarrja e KZAZ-së, e cila është në shumicë të opozitës në atë KZAZ, ka ndonjë shënim apo problematikë në lidhje me vlerësimin e votave gjatë numërimit në dokumentacion zgjedhor, si dhe në tabelat e grupeve të numërimit?

Z. I. Kaso: Ashtu siç e parashtroi edhe kolegu Nuri, dhe detyrohem ta përsëris, tabelat e numërimit për sa u përket të gjitha qendrave të numërimit, hartohen nga grupet e numërimit dhe në gjysmat e tyre minimalisht nuk ka pasur asnjë anëtar. Vëzhguesit sigurisht që kontestimet e tyre i kanë mbajtur shënim, çka na ka bërë ne dhe na ka dhënë indicien e parë për të kërkuar për ta shtyrë më thellë hetimin

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

administrativ, siç kemi bërë duke i kërkuar KQZ-së vënien në dispozicion të kamerave nga ku kanë dalë indicie të tjera e më të detajuara, siç i relatoi kolegu Nuri. Kështu që kjo ka qenë situata. Ndërsa për sa u përket shënimeve, ka pasur një mori shkeljesh në këtë zonë zgjedhore, të cilat kanë detyruar që një pjesë e mirë e KZAZ-së të votojë kundër tabelës përmbledhëse duke raportuar te mendimi i pakicës një pjesë të shkeljeve të tyre. Sigurisht, një pjesë e tyre referojnë te libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 45, një pjesë tjetër e tyre referojnë tek të njëjtat shkelje të cilat ne kemi evidentuar, por sigurisht ka pasur shkelje të mëdha të ligjit në këtë proces zgjedhor, veçanërisht në procesin e numërimit dhe tabulimit të rezultatit, por, sikundër thashë, edhe shkelje të cilat lidhen posaçërisht me këtë qendër votimi.

Z. L. Braho: Zoti Salianji, nëse nuk keni pyetje të tjera, vazhdoni me prapësimet.

Z. E Salianji: Në lidhje me tabelën që u dorëzua këtu para jush, ju i keni parë kamerat dhe keni hartuar një tabelë. Nga praktika, edhe kjo është për përfaqësuesin Kaso, i cili ka eksperiencë në këtë Komision, keni ndonjë fletë votimi të printuar nga ato çka ju i relatoni në një tabelë format A4, që ne të shikojmë ato fletë votimi të cilat pretendohen sipas shenjave që ju relatuat, pra këtu jemi në një gjykim, konstatohet një provë, gjendet fleta, subjekti i Partisë Demokratike nuk është hera e parë që ankimon dhe nuk kërkon rinumërim, ka pasur raste që ka ardhur me fletë votimi të printuara, ku i ka treguar KAS-it, por edhe neve fletën e votimit, e cila pretendohet, të paktën një fletë votimi, dy fletë, tre fletë votimi, nuk po them 60 fletë votimi, por ju keni hartuar një tabelë në format A4 me ca shifra, duke pretenduar disa shkelje, të cilat nuk janë shënuar në asnjë tabelë grupi numërimi, sikur edhe në 5 %, sikur edhe një tabelë të grupit të numërimit të kishin sjellë, jo të gjitha, një dy tabela, pra ju keni pasur 50% komisionerë aktivë, pavarësisht në dijeninë tonë ju

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

keni pasur komisionerë në të gjitha tavolinat, se kanë qenë komisionerët e opozitës, që ata kanë numëruar për sa i përket subjektit që ju ankimoni. Nga pamjet filmike, kemi ndonjë provë konkrete, se këtu kemi një tabelë, unë mund të sjellë një tabelë, që po, 68 fletë votimi janë të rregullta. Ajo tabela që keni ju, kam një tabelë që ekzistojnë të rregullta, në qoftë se ka fletë votimi gjatë këqyrjes së kamerave, minimumi si fillim prove...

Z. I. Kaso: Atëherë nuk kemi pasur as nevojë, as mundësi që të prodhojmë indicie të kësaj natyre, pasi gjithsesi do të ngelej në kuadrin e indicies. Sigurisht, i kemi kërkuar që në krye të herës materialet, që përpara se t'i drejtoheshim KAS-it dhe ta investonim në ankim, dhe vetëm para 3 ditësh na janë vënë në dispozicion këqyrja e materialit voluminoz, i cili ka mbaruar ditën e djeshme dhe besoj se tabela që kemi përpiluar me detajet që kemi përpiluar, kujtojmë në formë skematike kemi paraqitur shkeljet që ne kemi evidentuar në pjesën më të madhe të qendrave të votimit, ndoshta jo në të gjitha qendrat e votimit, do të kishte qenë më konviente për ne në qoftë se do të kishte qenë ankim i kotë ose i pabazuar që të paraqesim shkelje qoftë edhe më të rënda, edhe më të mëdha në numër, ndoshta në të gjitha qendrat e votimit, por jemi limituar vetëm në atë çfarë na ka parë syri për kohën e kufizuar në të cilën kemi mundur t'i shohim. Për sa i përket eksperiencës, nuk është se ka një eksperiencë të konsoliduar të paraqitjes së këtyre lloj indicieve ose fillimit të provës në KQZ ose në KAS. Natyra e pretendimeve, të cilat më pas janë evidentuar në formën që ankuesi i ka parë të mundur ose të arsyeshme ka qenë më e ndryshme duke filluar që nga pretendimet, të cilat kanë qenë vetëm me një pretendim gojor dhe më pas janë miratuar ose është investiguar më tej nga KQZ-ja deri në ato me akte ekspertimi të ekspertëve të pavarur siç ka pasur disa raste të subjekteve të tjera, të cilat kanë çuar në hapjen e kutive ose në evidentimin dhe këqyrjen e materialit zgjedhor. Kështu që

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

praktikat kanë qenë nga më të ndryshmet dhe nuk më duket ndonjë sakrilegj i madh që nuk i jemi përmbajtur një praktike të konsoliduar që nuk ekziston. Faleminderit!

Z. E Saliانji: Faleminderit, por do të thosha që qëndrimi i Partisë Socialiste nuk është për mos hapjen e kutisë. Ne kemi qenë që në fillim të herës, jo në këto zgjedhje, por në çdo palë zgjedhje, qysh në zgjedhjet e vitit 2009 që, kur ekziston një provë, kutitë duhet të hapen: të rinumërohen, të rivlerësohen. Por në rastin konkret ne nuk mundemi që ne KAS-in ta investojmë për të numëruar kutitë thjesht me një fletë format A4. Kur i kemi pasur mundësitë, siç edhe ju e thoni, keni pasur mundësi t'i shikoni, pavarësisht vonesës, madje në seancë paraprake unë i kam kërkuar administratës, duke ditur që do të ishim në këtë seancë sot, vëri në dispozicion kamerat. Në qoftë se aty vërtet ka indicie që shikohet se vlerësimi i fletës nuk është konform ligjit, atëherë, ok, hajde i hapim, i rivlerësojmë dhe i numërojmë këto fletë votimi këtu. Por të vish të kërkosh në KAS rinumërim dhe rivlerësim thjesht për një letër format A4, përmend disa shkelje, kjo shenja, ajo shenja dhe për më tepër KZAZ-ja në Belsh shumicën e ka pasur të opozitës. Pra, ai lloj vlerësimi të fletës, vetë e kanë vlerësuar atë lloj vendimmarrje për sa i përket vlerësimit të fletëve në çdo rast konkret edhe kur mund të ketë pasur diskutime. Atë çfarë sot e kërkojnë te ju, të nderuar, anëtarë të KAS-it, këta KQZ-në e kanë pasur në Belsh, kanë pasur shumicën. Çdo diskutim për sa i përket rinumërimit dhe rivlerësimit është bërë në atë KZAZ, nuk ka pasur në librin e protokollit asnjë diskutim nga KZAZ-ja në lidhje me vendimmarrjen, vetëm në fund, në momentin që doli rezultati, doli fituesi, atëherë humbësi nuk firmosi vendimmarrjen. Megjithatë, unë do të prapësoja në lidhje me pjesën e ngritjes së qendrës në burg. Në zgjedhjet e viteve 2015, 2019, 2023 ajo qendër votimi ka ekzistuar, ka ekzistuar jo se ka dëshiruar drejtori i burgut ose ka dëshiruar dikush tjetër, por e ka kërkuar ligji. Ligji në vitin 2010 ka pësuar

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

një ndryshim ku personat të cilët janë rezidentë më shumë se 3 muaj në një institucion, ajo është adresa e tyre, do të thotë ky ndryshim vjen pas atij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, pra ne lexojmë sot një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2007, por kemi një ligj të vitit 2010 që përcakton në mënyrë të qartë të gjitha procedurat konkrete, të drejtat që ka një i dënuar që i jepen atij nga qëndrimi në burg. Për sa i përket rastit të Belshit, i kemi me vendime gjykate të regjistruara, i kemi me vendime gjykate, nuk mundet t'i diskutojmë. Tani po diskutojmë këtu vendime gjykatash, janë 24 vendime gjykatash, të cilat i kanë dhënë të drejtën kushtetuese zgjedhësve për të votuar. Me të drejtë Komisioneri, në momentin që ka pasur vendimet e gjykatave, ka ngritur atë qendër votimi dhe me të drejtë palët kanë çuar komisionerët, pra, në qoftë se do të ishte kjo mosdakordësi për ngritjen e asaj qendre votimi, minimumi ju nuk do të kishit çuar komisionerin në atë qendër votimi. Por sot jemi në një rezultat, ku njëri do të fitojë, se njëri fiton, atëherë vjen humbësi ankohet për një gjë që tashmë është e ligjshme, që e drejta kushtetuese e të burgosurve në rastin konkret është një e drejtë legjitime të votojnë, ligji e ka përcaktuar fare qartë nenin 18 të gjendjes civile, që ai është vendbanimi, kur jeton më shumë se tre muaj. Do të përmend këtu një vendim të Tiranës, për rrugën "Jordan Misja", ai është paraburgim, mundet që gjykata ka gjykuar që i burgosuri hyn sot dhe ndryshon masa e sigurisë nesër, ndërsa për sa i përket Belshit, aty janë të dënuar që vuajnë dënimin me vite. Cili do të ishte rasti që një i dënuar ka një vendim prej 15 vjetësh, atëherë nuk ka të drejtë për të votuar? Ata janë që kanë dënime 10, 15 20 vjet në atë burg. Pra, ligjvënësi e ka përcaktuar këtë të drejtë të burgosurve si një e drejtë kushtetuese për të votuar dhe është përcaktuar me ligj ai që nuk voton. Pra, e drejta për të votuar hiqet me ligj. Ka persona të cilët i ka përcaktuar ligji, që nuk mund të votojnë, kurse personat e dënuar, siç është rasti në burgun e Kosovës, që kanë votuar në Belsh, janë persona që gëzojnë të drejtën për të votuar dhe normalisht

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

kjo e drejtë është dhënë edhe me vendim gjykate dhe ushtrohet, pavarësisht se cili ka dalë rezultati në numërimin e këtyre qendrave të votimit. Besoj e quaj të ezauruar këtë prapësim si ligji e gjendjes civile, si dhe Kodi Zgjedhor e kanë shumë të qartë të drejtën për të votuar, pavarësisht rezultatit që ka dalë aty gjatë numërimit. Për sa i përket rinumërimit dhe rivlerësimit në qendrat e votimit, unë e theksoj që ne jemi pro të rinumërohen e të rivlerësohen në ato qendra votimi ku ekziston të paktën një indicie, një shënim nga një numërues, ose të paktën vjen ankuesi dhe thotë, po, në këtë qendër votimi kemi këqyrur kamerën 9, në minutën e 40 të numërimit, e fotografuar kjo fletë votimi, është kjo shenjë, është e pavlefshme dhe është quajtur e vlefshme, dhe normalisht KAS-i ka të drejtën që ta rinumërojë e ta rivlerësojë këtë, por të vish e të kërkosh rinumërim të gjithë KZAZ-së, se këtu pothuajse janë listuar të gjitha qendrat e votimit me arsyetim të paprovuar, unë e shikoj të tepërt nga ana e ankuesit. Minimumi na sill edhe një qendër votimi, dy qendra, hapim ato dy qendra, i shikojmë, në qoftë se aty ndryshon, atëherë mund të ecet edhe me qendra të tjera. Por ka pasur këtu për këshilltarë ankues dhe KAS-i me të drejtë këshilltarë ka qenë e provuar që në një qendër votimi ka ndryshuar rezultati, por ka pasur një provë. Nuk mund të hapim praktikë në KAS me një format A4, tani heqim edhe kamerat, se me këtë praktikë që po bëjmë para jush është një kamerë këtu, por nuk ka asnjë vlerë. Thjesht e pamë, sjellim tabelën dhe e sjellim para KAS-it, pa e shoqëruar këtë tabelë me një provë konkrete, ndaj do të kërkoja që përsa i përket rinumërimit dhe rivlerësimit të paktën ti lini kohë. Meqenëse subjekti thotë që nuk ka patur kohë, lërin kohë ti shikojë kamerat dhe të evidentojë qendrat e votimit. E ka parë, e ka shumë të thjeshtë, në atë tabelë që ka sjellë aty thjesht të çojë... Të evidentojë QV-të ku janë këto fletë votimi, ti sjellë këtu të fotografuara dhe do të kërkoj unë hapjen e këtyre qendrave të votimit edhe nëqoftëse nuk e kërkon ankimesi. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit për transparencën zoti Salianji! Fjala për Sekretarin e Përgjithshëm në lidhje me prapësime, parashtrime, çfarë mund të ketë për kërkesën ankimore. Meqenëse shoh që edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disa shkresa për këtë procedurë.

Z. Y. Merkaj: Po, fillimisht do i përgjigjem pyetjes që bëri pala e interesuar. Në burgun e Kosovës edhe në vitin 2015 kanë qenë 192 zgjedhës, ndërsa në vitin 2019 kanë qenë 20 zgjedhës. Për votimin e 14 majit burgu i Kosovës i ka patur 7 komisionerët e qendrës së votimit. Këto ishin pyetjet që më bënë.

Z. L. Braho: Në një qendër votimi rezulton që kanë votuar 29 vetë, 24 kanë qenë të burgosur, nëse i shtojmë edhe 7 komisionerë duhet të ishin 31. Pra, kanë votuar 22 të burgosur? Dakord! Ndonjë tjetër zoti Sekretar i Përgjithshëm, në lidhje me ankimin, keni ndonjë qendrim?

Z. Y. Merkaj: Jo, por kam para një shkresë të Drejtorisë së Institucionit Ekzekutiv të Vendimit Penal Jordan Misja. Meqenëse pala ankuese solli një vendim gjykatë të Jordan Misjes që një gjyqtar paska refuzuar të drejtën e votimit, janë 188 vendime gjykatë që kanë lejuar të burgosurit të votojnë në burgun Jordan Misja.

Z. L. Braho: Çfarë domethënë kjo në lidhje me pretendimet e ankuesit? Çfarë prapësoni ju duke na referuar që ka patur...

Z. Y. Merkaj: Është vendimi i gjykatës që i lejon edhe në zgjedhjet vendore një të burgosuri të votojë.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. L. Braho: Dakord! Kisha unë një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm. Sollët ju një vendim të Komisionerit, vendimi nr. 501 për krijimin e QV-së së posaçme që është kjo që po bëjmë debat. Nga hyrja e vendimit thotë që Komisioneri vëren se funksioni i ZAZ-së nr. 45, Bashkia Belsh, me shkresën 50, 42 i propozon KQZ-së krijimin e kësaj qendre votimi. Ndërkohë këtu na vihet në dispozicion kjo kërkesë e protokolluar që nuk është kërkesë e KZAZ-së, por është kërkesë e Bashkisë Belsh, e nënshkruar me mungesë dhe me urdhër të kryetarit Arif Tafani nga Sekretari i Përgjithshëm. Kjo është shkresa që ju i referoheni si shkresa e KZAZ-së në të cilën është krijuar kjo QV e posaçme? Pra nuk është me propozim të KZAZ-së, por është me propozim të kryetarit të bashkisë?

Z. Y. Merkaç: Atëherë, sipas Kodit Zgjedhor është bashkia ajo që propozon ngritjen e QV-së, me propozim të KZAZ-së. Ky vendim është vendim i Bashkisë Belsh dhe mendoj se është në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Z. L. Braho: Ku është kjo dispozita? Nëse i referohesh nenit 43. Neni 43 thotë KZAZ-ja në përputhje me këtë kod sipas udhëzimeve të KQZ-së i propozon KQZ-së krijimin e QV-ve të posaçme në institucione të posaçme. Pra nuk përfshihet bashkia këtu.

Z. Y. Merkaç: Është edhe një shkresë 5042 protokoli, dt. 12.05....të KZAZ-së nr. 45 të Bashkisë Belsh, e cila i ka propozuar Komisionerit ngritjen e kësaj qendre votimi.

Z. L. Braho: Protokollin e KQZ-së e ka 5042. Thjesht na sqaroni është kjo shkresa me të cilën është krijuar kjo KQZ apo ka ndonjë shkresë tjetër?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Kjo është shkresa.

Z. L. Braho: Kjo është shkresa, dakord faleminderit!

Z. K. Bele: Më fal, këtë shkresën nuk e kuptoj. Këtu nuk kërkohet KZAZ, vetëm i kërkohet Komisionerit të vihet në dijeni për faktin që janë 24 vendime të shkruara nga kjo gjykatë. Nëse ka ndonjë shkresë tjetër apo nëse është ndonjë vendimmarrje kryesisht e Komisionerit, kjo ngelet për tu parë. Por nga çfarë e lexoj unë shkresën bashkia thotë: “Bëni regjistrimin e tyre”. Se çfarë kupton me regjistrim unë nuk e di, në gjendje civile, në listë apo... Por nuk i kërkon kjo KZAZ-së. Kështu që për të qenë korrekt me njëri- tjetrin kjo shkresë informon që 24 vendime gjykate i kanë dhënë të drejtën individëve që të votojnë. Kisha një pyetje për përfaqësuesin e ankuesit. Unë i pashë me vëmendje këto vendimet. Në fakt janë 5 gjyqtarë, jo 2, 3. Diku vendimi është me një faqe, para-mbrapa, diku është me 6 faqe, por nuk kemi fletën arsyetuese që të çmojmë nëse gjyqtari ka bërë hetim apo jo. Por kur them çmimi e them në thonjëza sepse ka të bëjë me çmimin tonë si jurist, për kulturën tonë të brendshme, por nuk e di a kemi ne... a na kërkohet ne këtu si organ i një hetimi si gjykatë si organ i apelit administrativ të zhbëjmë vendimmarrjen e gjykatës cilado qoftë racionalja e 5 gjyqtarëve rast pas rasti. A na kërkohet ne të disponojmë duke thënë se këto vendime gjykate nuk duhet të merren për bazë apo këto vendime gjykate nuk mjaftonin për të krijuar QV-në. Sepse nga elaborimi juaj na u duk se na u kërkua që të mos marrim parasysh ose ne si KAS të konstatojmë që këto vendime nuk janë në përputhje me ligjin.

Z. I. Kaso: Faleminderit për pyetjen! Sigurisht që nuk i kërkohet KAS-it që të shfuqizojë vendimet e gjykatës. I kërkohet të konstatojë faktin që vendimet e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

gjykatës kanë interpretuar ato që janë të arsyetuara në mënyrë të gabuar, ligjin, jo vetëm kodin zgjedhor por edhe detyrimet që burojnë nga dispozitat më të rëndësishme të Kodit Civil të cilat përcaktojnë nocionin e vendbanimit ndajnë atë qartazi nga nocioni i vendqendrimit siç është diskutimi i nenit 12 dhe 14 i Kodit Civil dhe për të marrë dijeni të faktit dhe për ta konstatuar për efekt të këtij shqyrtimi administrativ për zgjidhje të kësaj mosmarrëveshje zgjedhore të faktit që këta zgjedhës qoftë edhe të pajisuar me atë vendim gjykate nuk mundën të votonin, nuk duhet të votonin dhe nuk mundet kurrsesi të tabulohet një vullnet që qartazi nuk duhet të prodhohej pasi është marrë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të dy ligjeve, dhe jo ligjeve të zakonshme por ligjeve të miratuar me shumicë, të cilësuar siç është Kodi Civil, siç është Kodi Zgjedhor i cili rregullon spektrat zgjedhore. Për ti dhënë relevancën e duhur kësaj lloj shkelje në raport me mosmarrëveshjet zgjedhore të cilët jemi investuar për ti zgjidhur. Faleminderit!

Z. L. Braho : Kisha një pyetje për ankuesin. Te të gjithë vendimet e gjykatave që ju keni sjellë këtu, rezulton se të gjitha vendimet janë marrë përpara se të krijohet QV-ja. Janë 24 vendime që është parashikuar numri i QV-së dhe ku citohet se këta zgjedhës nuk janë në listë, nuk ka patur listë për këtë QV. Keni bërë ndonjë hetim me gjithë këto vendime gjyqësore përveç vendimeve që keni sjellë? Se çfarë përfshihet në provat që janë bashkëlidhur këtyre projektvendimeve, që janë marrë këto vendime. Janë marrë përpara se të krijohet QV-ja dhe kanë numrin e QV-së.

Z. I. Kaso: Atëherë, sigurisht mbajnë numrin e QV-së si remineshencë mund të themi, si një qendër votimi që ka patur ekzistuar në këtë institucion të vuajtjes së dënimit jo për këto lloj zgjedhjesh por për zgjedhjet e përgjithshme ku sigurisht e drejta kushtetuese për të ushtruar të drejtën e votës është e ndryshme ose e pakufizuar

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

në raport me të drejtën e votës, e cila mund të ushtrohet nga këta zgjedhës për këto lloj zgjedhjesh. Sikundër në datën 12 mars në mos gabohem është i njëjti numër QV-je së cilës i referohet edhe KZAZ-ja e cila ka bërë edhe hetimin e duhur nëqoftëse në këtë institucion të vuajtjes së dënimit ka patur apo jo shtetas të cilët mbas parashikimeve të ligjit u lind e drejta për të votuar në këtë QV. Pra për të referuar pak te prapësimet që bëri përfaqësuesi i PS-së, ku ju referua dhe Ligjit për Gjendjen Civile, citoi nje dispozitë, nenin 18, pika 3 në mos gaboj ku ju referua kohëzgjatjes së qendrimit të një të dënuari që vuan dënimin në një institucion të vuajtjes së dënimit, për ta kthyer atë që Kodi Civil parashikon si vendqendrim në vendbanim për efekt të Ligjit për Gjendjen Civile. Pa u ndalur tek kontrasti i hierarkisë së normave, të parashikimeve të Kodit Civil në raport me ato të një ligji që miratohet me shumicë të thjeshtë, pa e prekur fare këtë aspekt siç është momenti i vlerësimit tuaj, do të ndalesha tek fakti që hetimi që kërkon KAS-i që ta bënim ne... kërkon ose pyet, jo në mënyrë urdhërore por që ka kureshtje të dijë nëqoftëse e kemi bërë ne. Ne e konsiderojmë të ezauruar nga hetimi që vet KZAZ-ja ka bërë. Në mars KZAZ-ja konstaton, në mënyrë të pakontestuar nga asnjëri nga anëtarët e KZAZ-së, nga të cilët vetëm një ishte përfaqësues i subjektit tonë zgjedhor, pavarësisht se mazhoranca thuhet shpesh edhe u tha edhe për efekt edhe të konsumimit publik dhe të sugjestionimit të KAS-it sikur subjekti jonë ka patur mazhorancën në këtë KZAZ. Sigurisht që nuk e ka patur. Sigurisht që ka patur të drejtën e vetëm 1 anëtar dhe nëqoftëse 3 anëtar të tjerë janë dakordësuar me anëtarin e propozuar nga subjekti jonë, është çështje e tyre dhe çështje e përgjegjësisë së tyre për efekt të zbatimit të ligjit dhe jo i favorit që i bëjnë x apo y kandidati, për këtë të jeni të sigurt. Të 7 anëtarët bashkarisht e kanë ezauruar hetimin e tyre dhe vërejnë që as për efekt të dispozitave të Kodit Civil, as për efekt të dispozitave të Ligjit të Gjendjes Civile neni 18, pra të kohëzgjatjes të qendrimit tuaj në këtë institucion dhe as për efekt të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Zgjedhor, në këtë qendër nuk ka shtetas, të cilët të kenë të drejtën e votës për këtë zonë zgjedhore. Unë jo pa qëllim referova dhe një vendimmarrje të Gjykatës së Tiranës, e cila në mënyrë shumë eksplicite vendoset në një linjë me këtë vendimmarrje të pandikuar të KZAZ-së, e cila e zgjidh çështjen që në kryet-herët pa u futur më pas në interesat politike, pasi nëse do i referohemi shkresës që na u vu në dispozicion dhe që ka investuar KQZ-në për ngritjen e kësaj qendre të posaçme jo vetëm që është diktuar nga interesat e njërit prej kandidatëve në garën zgjedhore, por edhe të kandidatit që ka përfituar më shumë nga ngritja e qendrës së posaçme, pikërisht 2 ditë para zgjedhjeve. Vërtet referohet se është kërkesë e Bashkisë Belsh, por sigurisht është bërë në emër dhe për llogari të kandidatit garues, kandidatit rival me kandidatin ankimues, kandidatit, Arif Tafani. Faleminderit!

Z. E. Lako: Meqenëse jemi këtu, pak a shumë u sqaruam në lidhje me këtë pikë, por një pyetje të thjeshtë për përfaqësuesit dhe ankuesit. Ne po merremi shume me këtë qendër të pocaçme sepse këtu pak a shumë është përqëndruar dhe ankimi juaj, por një pyetje. Përse nuk u bë ankim kundër vendimit të Komisionerit në momentin e ngritjes së kësaj qendre sepse mendoj se këto debate mund të ishin ezauruar në atë mbledhje, gjatë mbledhjes ose pas marrjes së vendimit mund të ishte bërë një ankim sipas ligjit dhe të kishe ndjekur rrugën ligjore, sepse tani ky vendim nuk është ankuar, ka marrë formë të prerë, ka prodhuar efekte dhe ne po merremi më shumë me aktin e nxjerrë nga Komisioneri në atë kohë sesa me pasojat të cilat nuk mund ti dinte njëri se si do të dilte numërimi në këtë zonë. Pra pse nuk është kundërshtuar në atë kohë dhe pse nuk është bërë ankim sipas ligjit ku ky vendim vetë e ka dhënë të drejtën e ankimit. Ju keni konstatuar që ka kaq shumë paligjshmëri për sa i përket regjistrimit apo ngritjes së kësaj qendre. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Atëherë jo vetëm akti i Komisionerit është marë në një moment të dytë, në një moment shumë afër procesit zgjedhor dhe ne jemi vënë në dijeni në një moment të dytë lidhur me këtë akt dhe afërsia e marrjes së këtij akti me momentin e fillimit të prodhimit të efekteve të këtij akti, që në atë moment të urdhërohej KZAZ-ja të përcaktonte 7 anëtarë të komisionit. Që në atë moment fillonte shpërndarja e materialeve zgjedhore për atë qendër votimi, që në atë moment duhet që të merrnin materialet zgjedhore, QV-ja duhet të shkonte të përgatiste qendrën etj, etj...Nuk është parë efektive në atë moment kundërshtimi i këtij akti, i cili ishte vetëm i fundmi i një zinxhiri aktesh të cilat lindin me shkelje flagrante të dispozitave urdhëruese të ligjit dhe përfundojnë me një shkelje masive të ligjit. Ne në thelb të kërkimit tonë sot nuk kemi shfuqizimin e vendimit të komisionerit që të ngrejë qendrën e posaçme, kemi zgjidhjen e pasojave që sikundër ju thatë janë prodhuar por që për fat të keq të atyre që kanë votuar atje dhe e kanë ushtruar të drejtën e votës atje në kundërshtim me atë çfarë parashikon ligji, janë pasoja të paligjshme. Këto pasoja të paligjshme ne kemi edhe sugjerimin tonë si mund të zgjidhen dhe është ajo që kemi edhe në kërkesë që këto pasoja të paligjshme kurrsesi nuk mund të reflektohen në tabelën përmbledhëse të këtij rezultati zgjedhor dhe nuk duhet të bëhen pjesë e tij. Faleminderit!

Z. L. Braho: Ndonjë pyetje tjetër? Po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Shkresa e KZAZ-së që i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që KQV-ja me numër 2568\1 të mos ngrihet në burgun e Lushnjës, mban datën 25.03.2023. Keni dijeni ju, ndoshta keni dijeni dhe nëse keni dijeni na e thoni. Pse KZAZ-ja ka arritur në konkluzionin se nuk ka banorë të Bashkisë Belsh në këtë institucion?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso: Faleminderit për pyetjen! Ne besojmë nga anëtari i vetëm që kemi patur në KZAZ ose nga dijenia që kemi përmes diskuimit që është zhvilluar ka qenë ajo çfarë unë u përpoqa të them edhe më parë, interpretimi korrekt i ligjit që ka bërë KZAZ-ja, duke e raportuar drejt të drejtën e këtyre zgjedhësve ose të drejtën e shtetasve të cilët mbahen në këto kushte në këtë institucion të vuajtjes së dënimit, në raport me këto lloj zgjedhjesh për të votuar ose jo në atë zonë zgjedhore.

Z. I. Rusmali: Që mos ta themi dy herë. KZAZ-ja thoni ju, nuk ka shpjegim tjetër përveçse të ketë arritur në konkluzionin që njerëzit në burg nuk duhet të votojnë.

Z. I. Kaso: KZAZ-ja në vlerësimin tonë, ose nga informacionet tona ka arritur në këtë konkluzion për shkak se ka evidentuar, sikundër e thotë dhe në shkresë se nuk ka banorë të Bashkisë Belsh. Nuk ka evidentuar në këtë institucion vuajtje dënimi shtetas të cilët ta kenë vendbanimin Bashkia Belsh dhe rrjedhimisht sipas leximit që ata i kanë bërë dispozitave që citova nuk u lind e drejta që të votojnë në këtë zonë.

Z. I. Kaso: Pra në burg mund të votohet, por mund të votohet nëse je banor?

Z. I. Kaso: Sipas interpretimit të KZAZ-së po.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ekziston mundësia që KZAZ-ja të dalë më konkluzion që nuk ka banorë, sepse po të kishte banorë duhej të votonin nisur nga të dhënat që ajo ka nxjerrë nga lista e zgjedhësve?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso: Unë besoj ajo sigurisht në momentin e saj të parë të verifikimit ka patur raportimin e vendimmarrjes së saj me listën e zgjedhësve që ka disponuar, por nga çfarë jemi vënë në dijeni sigurisht ka patur edhe komunikime edhe me vet institucionin e vuajtjes së dënimit. Jo të pasqyruar, por interesimit të KZAZ-së në institucionin e vuajtjes së dënimit nëse në këtë institucion të vuajtjes së dënimit ka shtetas të cilët e kanë vendbanimin Belsh, pra që të mund të legjitimoheshin, të votonin sipas KZAZ-së në këtë qendër, institucioni është përgjigjur që nuk ka shtetas, nuk ka banues ose shtetas me vendbanim Bashkia Belsh.

Z. I. Rusmali: Nëse do të kishte shtetas me vendbanimin Bashkia Belsh në institucionin e vuajtjes së dënimit, në cilën listë do të regjistroheshin ata?

Z. I. Kaso: Atëherë unë besoj se duhej bërë një lexim shumë i kujdesshëm le të themi jo vetëm lexim haronik i dispozitave të Kodit Vivil në raport me ato që përcaktojnë, nocionin e vendbanimit dhe vendqendrimit në raport me ato çfarë u referua për sa i përket nenit 19 të Ligjit të Gjendjes Civile, ku nëse do të kishte ndonjë hipotezë ose nëse unë do të isha i thirrur që të interpretoja ligjin shtetas të cilët në momentin e hartimit të listës përfundimtare të zgjedhësve do të kishi...pra në datën 4 prill do të kishin vendbanimin Bashkia Belsh do të duhet të votonin në qendrën e votimit në të cilën atyre shtetasve u rezulton dhe emri në listën përfundimtare të zgjedhësve, pra në një qendër tjetër votimi. Në rast se institucioni i vuajtjes së dënimit nuk do të ishte kujdesur që deri në datën 4 prill pra në momentin në të cilën hartohet lista përfundimtare e zgjedhësve, zgjedhësit që e kanë vendbanimin Bashkia Belsh ose që kanë më shumë se tre muaj ose të paktën 3 muaj qendrim të pandërprerë në këtë institucion të vuajtjes së dënimit tua kishte sjellë vendbanimin siç parashikon neni 18 i Ligjit të Gjendjes Civile në këtë institucion.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Rusmali: E thënë pak më shqip, në qoftë se do të kishte banor, ata do të ishin në listën e burgut, në qoftë se Drejtori i Burgut, do të kishte bërë regjistrimin e tyre të rregullt në zyrën e Gjendjes Civile.

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Po në datën 4 Prill.

Z. I. Rusmali: Kjo gjë nuk ka ndodhur, besoj mund ta konfirmojmë këtë fakt.

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Po. E konfirmon KZAZ-ja.

Z. I. Rusmali: Nuk ka ndodhur, nuk ka pasur listë zgjedhësish të burgut për pasojë është normale të thuash që sa kohë nuk ka listë zgjedhësish, nuk ka banorë. Kjo është lidhja direkte që ne bëjmë midis qënies banor dhe qënies në listë apo jo?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Kjo është.

Z. I. Rusmali: Mirë, ju keni dijeni në qoftë se keni, për historitë individuale të 24 personave, 22 në fakt? Domethënë sa janë dënuar, kur janë strehuar në burgun e Lushnjes, sa kohë parashikohet të jetojnë aty. Domethënë të dhëna të historikut të vuajtjes së dënimit? Keni juve, dispononi?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Faleminderit i nderuar. Neve na ka ardhur gjysëm ore përpara se të fillonte seanca një kthim përgjigje, kërkesës tonë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku i kërkojmë pikërisht të njëjtat informacione për sa i përket dy institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe shetëtasve të cilët kanë votuar në këtë institucion të vuajtjes së dënimit për sa i përket IEVP-së Kosovë Lushnje që

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

ndodhet në Bashkinë Belsh. Por edhe asaj Rrogozhinë të cilën e referojmë përpara kolegëve të Partisë Socialiste dhe na janë vënë në dispozicion disa lista skematike, në të cilën gjendet edhe përgjigja e kuriozitetit të relatorit lidhur me shtetasit të cilët votonin ose kanë votuar domethënë e kanë bërë efektive të drejtën e tyre të votës. Pra nga grupi prej 24 shtetasish të cilët, gjykata e Elbasanit iu dha të drejtën të votojnë në këtë Qëndër Votimi pavarësisht se nuk ishte ngritur. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve thotë ose referon që vetëm 22 prej tyre e kanë ushtruar të drejtën e votës. Përgjigje skematike na vjen me emër mbiemër atësi të dënuarve, datën e lindjes, veprën penale, numri i vendimit nga gjykata numër personal, pra nuk jepen të dhëna prej sa kohësh janë në atë institucion të vuatjes së dënimit ose për sa kohë parashikohet që ta vuajnë.

Z. I. Rusmali: Ju i keni kërkuar këto të dhëna? Këto specifikat e historikut të vuatjes së dënimit?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Neve kemi kërkuar listën e të dënuarve jo vetëm të cilët kanë votuar, në këto institucione të vuatjes së dënimit, por mbi të gjitha u kemi kërkuar në rradhë të parë listën e këtyre shtetasve. Të cilët gjëndeshin në këto institucione të vuatjes së dënimit, në momentin e daljes, minimalisht të daljes së listës përfundimtare e cila ka qenë data 4 Prill në mos gabohem. Informacioni ka ardhur në këtë mënyrë. Gjithashtu kemi kërkuar edhe listën e të dënuarve, të cilët për shkak të ndalimeve të ndodhura në ligjin për dekriminalizimin në nenin 2 të tij, nuk u lejohej, prisheshin nga e drejta e votës siç e parashikon legjislatori. Përsëri na ka ardhur një numër ekzakt i të dënuarve në dy institucionet e vuatjes së dënimit, të cilët futeshin në ndalimet sipas administratës së burgjeve në ndalimet e parashikuara nga ligji për dekriminalizimin por jo lista emërore e tyre dhe veprat për të cilat janë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

dënuar. Pra, thuhet shkurtimisht në përgjigjen në qoftë se mund ta referojë, që në këtë institucion të vuatjes së dënimit janë fiks 100 shtetas pra në IEVP-në Kosovë-Lushnje, të cilët për shkak se veprat për të cilët ata janë dënuar përfshihen në fushën e ndalimeve të parashikuara nga neni 2 për dekriminalizimin nuk lejohet që të votojnë në asnjë mënyrë as në këtë zonë as në zonë tjetër.

Z. I. Rusmali: Ju nuk keni asnjë mundësi?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: As të dhëna të tjera më të detajuara të cilat i kemi kërkuar.

Z. I. Rusmali: Ju nuk keni asnjë mundësi që të nxirrni të dhëna nëse ndonjë nga këta persona që është, që ska votuar me vendim gjyqësor është në listën e ndaluar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve apo jo?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Për fat të keq nuk e kemi këtë të dhënë sepse nuk na ka ardhur në këtë mënyrë përgjigja.

Z. I. Rusmali: Mund ti administrojmë këto shkresa?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Po patjetër.

Z. I. Rusmali: Nëse mund të vazhdojmë, unë do i kthehem pak pyetjes së kolegut që tha pak më përpara, ndoshta duke e kapur nga një anë tjetër sepse mu duk sikur nuk i dhatë përgjigje. Komisioni i Qendrës së Votimit, e ka ligjërisht opsionin që të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

ndalojë, që të bëjë që të mos votohen, të mos lejohen të votojnë persona që shkojnë aty me vendim gjyqësor?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Në kuptimin tonë të ligjit jo, nuk e ka.

Z. I. Rusmali: KQZ domethënë unë besoj se nuk po merrem me bashkinë, por Komisioneri KQZ, a e kanë opsionin që ti bëjnë analizë juridike një vendimi gjyqësor dhe të dalin në konkluzionin që në vlerësimin tonë ky vendim gjyqësor është i paligjshëm dhe ne nuk e zbatojmë?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Unë besoj që do të ishte tepër ti kërkonim këtë gjë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në momentin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ngre një QV jo ashtu siç e parashikon dispozita urdhëruese e ligjit neni 43 me kërkesë të KZAZ por me një kërkesë të një kandidati në garë. Kështu që ti kërkojmë edhe një ...

Z. I. Rusmali: Ne këtu në KAS, nuk kemi ngritur QV.

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Jo, jo. E kam fjalën për komisionerin.

Z. I. Rusmali: Të lutem se e kuptova. Ne e kemi opsionin të themi në vlerësimin tonë, vlerësimi i gjykatës është non sens juridik. Është i paligjshëm dhe ne e konsiderojmë atë të pa zbatueshëm. E kemi ne të drejtën të bëjmë si struktura administrative, të bëjmë një vlerësim ligjor për një vendim gjyqësor.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Atëhere, unë besoj sikundër e thashë përpara që vlerësimi që i bën KAS kësaj çështje nuk ka të bëjë me ligjshmërinë ose jo të vendimmarrjes të gjykatës. Pra, që në mënyrë paradoksale le të themi as nuk i kërkojmë KAS që të shprehet lidhur me vendimin e gjykatës. Ajo çka KAS duhet të shprehet në zgjidhjen e drejtë të kësaj mosmarrëveshje zgjedhore është vlerësimi i drejtë i pasojave që këto vendime gjykate në kendvështrimin tonë jo të bazuar në ligj, qartazi jo të bazuara në ligj, mendojmë ne. Efektin që ato kanë prodhuar në procesin zgjedhor, pra ky efekt që ato kanë prodhuar është ligjor, është zgjedhor, është i tabulueshëm. Duhet të ekzistojë në tabelën përfundimtare të zgjedhjeve ose në tabelën përfundimtare të rezultatit të kandidatit për kryetar në këtë zonë zgjedhore. Apo mundet të mos tabulohet sikundër është edhe kërkesa jonë. Ne vlerësojmë që KAS e ka një tagër të tillë, pasi nuk vepron thjesht si një organ administrativ por vepron si një organ quazi gjyqësor në zgjidhjen e një mos marrëveshje zgjedhore. Besoj qartazi sikundër ka ndodhur edhe në raste të tjera, veprime të cilat janë bërë fakt i kryer kanë prodhuar pasoja. Por kanë qenë të pa bazuara në ligj, kanë marrë një vlerë të caktuar në raport me prodhimin e rezultatit përfundimtar, në raport me tabulimin e rezultatit përfundimtar dhe të shpalljes së fituesit në një garë zgjedhore. Mund të sjellë raste, ka pasur raste pa fund. Ne jemi referuar , ndoshta do të ndalesha edhe në konkluzionet përfundimtare çështjes së pavlefshmërisë por që e kemi laboruar si koncept dhe do të ndalemi me gjerë në konkluzionet përfundimtare por ka pasur raste kur për shkak të vendimmarrjeve, të cilat më pas kanë rezultuar që janë të pa drejta, të nivelit të dytë të administratës zgjedhore të zgjedhjet e vitit 2009 përshëmbull

Z. I. Rusmali: Paralelizmin e dua me vendimmarrje gjyqësore.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Mua nuk më kujtohet më gjyqësore por analogjinë e sjellë me atë çka mua me kujtohet që është me raste vendimmarrjesh të administratës zgjedhore të cilat kanë qenë më pas të pa bazuara...

Z. I. Rusmali: Analogjinë më fal që të ndërpresë është harxhim kohe...

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: E kam fjalën tek prodhimi i efektit jo tek... nuk e kemi ekzaktësisht..

Z. I. Rusmali: Nuk e kemi praktikë të një organi administrativ që injoron një vendim gjyqësor, e lejmë mënjane dhe përgjigjen unë jam i kënaqur me përgjigjen, mora shumë në fakt. Kalojmë tek pyetja tjetër nuk kemi pse bëjmë analogji atje ku nuk ka analogji.

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Do të sillja vetëm për pasojat por megjithatë meqë është zgjatje e kotë domethënë , e kisha të pasojat jo tek lloji i vendimit që ka marrë organi.

Z. I. Rusmali: U keqkuptuam ti mund të thuash gjithçka që ti mendon se i vlen këtij procesi. Unë po thoja vetëm mos krijo analogji atje ku nuk ka, vetëm kaq.

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Qartë, nuk është rasti ekzakt, e pranoj unë i pari.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Rusmali: Ndoshta më vonë një pyetje për zotin Kaso, disa pyetje sqaruese për zotin Nuri. Ju keni bërë kqyrjen nga numërimi i qendrave të votimit apo jo?

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Po i ka bërë kandidati me stafin e tij më saktësisht.

Z. I. Rusmali: Për QV 2551 vjen nga kqyrja e pamjeve video apo nga dëshmitë e vëzhguesve.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: E keni fjalën për të parën 2551.

Z. B. Qypi: Atëherë, këto dy fletë votimi janë gjetur në momentin

Z. I. Rusmali: E dimë se e keni shkruar. Keni parë pamjet video dhe keni bërë konstatimin apo ?

Z. B. Qypi: Jo, jo ne i kemi paraqitur ato se ato janë gjetur në momentin sapo votimi ka mbaruar dhe janë paraqitur nga komisioni KZAZ Belsh.

Z. I. Rusmali: Pjesë e dëshmisë e personave pjesëmarrës aty.

Z. B. Qypi: Është marrë nga komisioni, nga KZAZ Belsh. Këto dy fletë janë gjetur tek aparati i kamerës që i përkasin kandidatit...

Z. I. Rusmali: Kanë qenë prezent aty, kanë mbajtur shënim në librin e protokollit. Do të thotë në qoftë se ne kërkojmë librin e protokollit ne do të gjejmë shënimin... ju keni kopje të kësaj flete.

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. B. Qypi: Jo nuk e kam.

Z. I. Rusmali: Nuk e keni. Më sakt nuk na referoni dot se kur ka ndodhur kjo, në cilën datë, në cilën orë, më vonë nuk ka problem. Vetëm të orientohemi saktë tek...

Z. B. Qypi: Këto fletë nuk i kam gjetur unë, i ka gjetur KZAZ nr.45 dhe më ka orientuar që dy fletë janë gjetur tek grupi i numërimit nr.1.

Z. I. Rusmali: Shumë e qartë nëse neve ua kërkojmë ju, që të gjitha këto votat që janë me shenja dalluese, që ju dalin juve nga kqyrja e pamjeve video. Të na i eksportoni në print na e bëni dot këtë gjë? Të na i paraqesni këtu?


Z. B. Qypi: Patjetër që po. Ato janë të dallueshme në ekran kur i sheh.

Z. I. Rusmali: Lidhur me QV 2564, 2565 janë disa vota tek cila njëra vulë nuk lexohet mirë. Nuk lexohet mirë, nuk dallohet fare, apo është vula, është konturi, po nuk është i plotë?

Z. B. Qypi: Nga një person që kam pasur në këtë qendër ka pasur probleme me bojën dhe disa nuk mund ta gjykoj dot që nuk lexohet ose nuk është vendosur fare. Po njëra vulë nuk është e dallueshme shumë.

Z. I. Rusmali: Po neve nga materiali që mund të na vini juve print mund të krijojmë një ide vetë për këtë punë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. B. Qypi: Patjetër.

Z. I. Rusmali: Mirë, unë tani për tani nuk kam më pyetje.

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje për zotin Kaso. Atëherë, zoti Kaso ju na relatuat në lidhje me referimet që bën Kodi Civil dhe Ligji për Gjendjen Civile dhe folët edhe për hierarkinë e normave, ku ka një ndryshim midis vendbanimit nga Kodi Civil tek Ligji për Gjendjen Civile. A keni ju një informacion se sa nga këta të burgosur që kanë votuar kanë qenë me vendbanim në Bashkinë e Belshit përpara se sa të burgoseshin?

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Faleminderit neve informacionin e kemi nga vendimmarrje e KZAZ-së dhe nga ajo çka na është referuar nga anëtari ynë, në KZAZ i propozuari prej nesh dhe i emëruari nga KQZ. Që asnjë prej zgjedhësve të cilët ndodheshin në këtë institucion të vuajtes së dënimit në momentin që ata e kanë marrë vendimin për ti propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mos ngritjen e kësaj qëndre, nuk e kishte vendbanimin Bashkia Belsh.

Z. I. Rusmali: Zoti Kaso, lidhur me listën e zgjedhësve të burgut, interpretimi juaj që këta njerëz nuk duhet të kishin votuar qoftë edhe me vendim gjykate sepse nuk i takon ligjërish të votonin. Është vetëm i lidhur me analizën që ju i bëni vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe hierarkisë së normave apo është i lidhur me të dhënat personale të tyre dhe me kushtin që përcakton Ligji për Gjendjen Civile, për banimin tre mujor në institucion. Janë njëra apo tjetra apo të gjitha bashkë?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso, përfaqësues i BF-së: Faleminderit i nderuar! Unë besoj që janë të gjitha bashkë, në raport me atë çka parashikon ligji, që parashikon nocionin e vendbanimit dhe të vendqëndrimit. Me të dhënat e tyre personale, sepse sigurisht ligji dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cili detajon këtë kufizim. Në momentin që Gjykata Kushtetuese është investuar në vitin 2007, sigurisht e kufizon të drejtën e votës së këtyre zgjedhësve në raport me vendbanimin. Po nuk është se e anulon krejtësisht, pra e lejon për ata që e kanë vendbanimin që ta ushtrojnë të drejtën e votës aty ku ata kanë vendbanimin e plotësuar kjo nga dispozita e Ligjit për Gjendjen Civile, i cili do të lehtësonte punën dhe jetën e administratës të burgjeve që në qoftë se do të kishte shtetas të cilët do ta kishin pasur vendbanimin në këtë zonë zgjedhore zonën e madhe zgjedhore Bashkia Belsh, në momentin e hartimit të listës, përfundimtare të zgjedhësve, të ishte kujdesur që për ata zgjedhës që do ta kishin vendbanimin në Bashkinë Belsh. Tua kishte kishte ndryshuar në raport me detyrimin që i përcakton Ligji i Gjendjes Civile për këto organe për ata shtetas, të cilët ishin rezident prej të paktën 3 muajsh në atë institucion të vuatjes së dënimit. Pra, në qoftë se nuk do ti kishte sjellë, administrata e burgjeve, po të kishte pasur shtetas, në datën 4 Prill, që ta kishin vendbanimin në burg, atëherë do të duhej që administrata e burgjeve të merrte masa që këta shtetas ti shoqëronte në qendrat përkatëse të votimit, duke u garantuar atyre të drejtën që Kodi Civil, Ligji për Gjendjen Civile, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Kodi Zgjedhor, etj, etj, u lejonë shtetasve për të votuar në këtë lloj zgjedhjesh.

Z. I. Rusmali: Unë kam një pyetje të fundit për Sekretarin e Përgjithshëm. Zoti Merkaj ndoshta ju keni dijeni besoj, shpresoj, në këtë QV praktikisht është votuar vetëm me vendim gjyqësor të burgosurit dhe me të drejtën ligjore anëtarët e komisionit. Vetëm kaq, këto janë votat e hedhura në këtë QV. QV në burgje, në

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

territorin e Shqipërisë, ku të burgosurit të kenë pasur emrin e tyre në listat e zgjedhësve të burgut ka pasur , ka nëpër Shqipëri të tilla? Që të jenë regjistruar në Gjendjes Civile si banorë të institucionit të edukimit apo nuk e keni këtë informacioni?

Z. Y. Merkaj: Nuk e kemi këtë informacion. Zakonisht praktika nuk është, se i bëjnë vetë këto listat. Nuk është se, institucioni i Burgjeve i dërgon ato kërkesat tek Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile për të ndryshuar vendbanimin.

Z. I. Rusmali: Në rregull, kjo është me kompetencë, kjo që po thua? Nga eksperiencia do të thotë, institucionet e burgimit, burgjet, drejtoritë, nuk zbatojnë si rregull dispozitën ligjore që i detyron që të regjistrojnë, në regjistrin e Gjendjes Civile të burgosurit që i mbajnë aty për një periudhë më të gjatë se 3 muaj, por kujtohen për këtë punë vetëm në momentin e zgjedhjeve. Kjo është ajo thoni?

Z. Y. Merkaj: Po në përgjithësi kështu është. Po ka edhe burgje që e respektojnë këtë që thatë.

Z. I. Rusmali: Në rregull tani u bë relatimi.

Z. Y. Merkaj: Po, ka sepse Burgu i Tiranës përshëmbull e respekton.

Z. I. Rusmali: E respekton i Tiranës. Po ato 180 veta me vendim gjyqësor aq ishin?

Z. Y. Merkaj: Janë dy burgje është “Jordan Misja” është edhe burgu tjetër.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Rusmali: Në rregull.

Z. L. Braho: Po zoti Nuri!

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF-së: Një saktësim, të vogël në lidhje me pyetjen që bëri anëtari i KAS zoti Rusmajli për momentin kur është shënuar në procesverbal lidhur me QV 2551. Informacioni që më vjen tani me fotografi lidhur me fletën e procesverbalit, tip KQZ 0201 evidentohet data 17 Maj 2022 ora 10:00. Është fotografuar fleta e procesverbalit e firmosur nga anëtarët. Po të gjejmë mënyrën për tua transmetuar, ku është shënuar që gjatë numërimit ka ndodhur një gabim njërëzor, fillon fjalia që në krye të herës. Në rregull, faleminderit.

Z. L. Braho: Në rregull, faleminderit zoti Nuri!

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Mund të jap një sqarim se u interesova në KZAZ-në në pjesën tjetër çfarë ka ndodhur, thjesht për sqarim që ta dini?

Z. L. Braho: Po na sqaroni edhe ju patjetër.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. E. Salianji: Tani mund të vihet në dispozicion tabela e grupit të numërimit, për qendrën 2551 po të vëreni aty korespondojnë, duhet të shohim fletët e personave që kanë votuar ka një rubrik, Ylli mund ta kemi atë tabelën e grupit të numërimit.

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. E. Salianji: Ma jepni ju lutem, ta shpjegoj më mirë me tabelë. Numri zgjedhësve që kanë votuar 301, fletë votimi të papërdorura 331, fletë votimi të dëmtuara 0, fletë votimi të gjetura në kuti 301, pra këto 301 fletë votimi janë gjetur në kuti dhe duhet të shikojmë që këto 301 fletë votimi duhet të ndahen sipas subjekteve nëse do të mungojnë 2 fletë votimi atëherë janë këto dy fletë që thotë ankuesi. Vota të pavlefshme 7 dhe kjo mbahet shënim, Arif Faik Tafani 168 fletë, Bedri Qypi 126 fletë, kur i mbledh këto 294 plus 7 të pavlefshme 301 fletë, tani mund të ishin edhe 10 fletë jashtë kutisë, edhe nëse do të na dilte që këto fletë nuk ishin përfshirë në këtë rezultat atëherë normalisht mund të diskutonim për këto fletë që t'i fusnim në rezultat. Këto fletë janë futur në rezultat, pra nuk janë 303 fletë votimi të gjetura në kuti dhe kanë prodhuar rezultat 301 dhe kemi dy fletë të pavlersuara, të 301 fletët e gjetura në kuti janë të vlersuara.

Z. L. Braho: Tani këta në procesverbal thonë që këto dy fletët janë poshtë makinerisë së skanimit. Athonë ashtu në procesverbal?

Z. E. Salianji: Edhe njëherë fletët e votimit janë hapur, janë numëruar është plotësuar tabela e grupit të numërimit është hedhur në bazë të tabulimit, mbas tabulimit të tabelës kur janë hedhur në kutinë e materialeve zgjedhore që është

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

mbyllur kutia mbas numërimit atëherë mund të kenë ngelur këto fletë votimi jashtë, por rezultat këto dy fletë kanë prodhuar edhe ju po ti keni këtu unë jua them për ekonomi gjyqësore se ju merrini ato fletë ju prap nuk i futni dot në rezultat se ato tashmë janë të futura në rezultat.

Z. I. Kaso: Mundet se ka një gabim në mbledhje dhe tabela, u referua $168 + 126 = 294$ plus 7 fletë 301, kur tabela rakordon dhe vendimi me 7 vota, KZAZ-ja thotë që skanë qënë fare ato dy fletë, llogarit çfarë është bërë.

Z. E. Salianji: Tani do ta ndajmë në hapsirë në kohë, kjo është një gjë shumë e vogël që do tju bëj ju që të provoni që ankuesi duhet të jetë të paktën logjikisht, aritmetikisht i drejtë në kërkimin e tij. Do të thotë që tabela e grupit të numërimit është një tabelë e cila është numëruar në orën 02:00 dhe në orën 02:00 kjo tabelë e grupit të numërimit e ka nxjerrë fotografi shumë qartë, KZAZ-ja mbasi ka dalë humbësi thotë kam gjetur edhe këto fletë votimi, të cilët vërtetë janë gjetur por janë të tabuluara këto janë harruar në bazë të numërimit, pra është tabuluar tabela kur është mbyllur me fletën e votimit, që janë hedhur në kutinë e materialeve aty mund të kenë mbetur dy fletë votimi të cilët mund të jenë të kësaj qendre mund të jenë të qendrës tjetër, por kjo qendër e ke të qartë nuk mungon asnjë votë.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Salianji, po zoti Rusmaili.

Z. I. Rusmali: Një pyetje tjetër, shpresoj e fundit për zotin Nuri ose për kandidatin kush e ka informacionin, për 2551 ne gjetëm një gjurmë në librin e protokollit, na e dhaqtë ju, ne do ta verifikojmë me origjinalin dhe besoj do të kemi mundësi që të

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

gjykojmë mbi të, për të gjitha këto konstatimet e tjera që vijnë pas me këtë tabelë ose për ndonjërin nga ato... në djeninë tuaj. Ka patur kontestime gjatë procesit? Kontestime procedurale nuk po them që sjam dakord, po kontestim procedural, zoti Nuri e di çështë kontestimi procedural. A ka patur në vijim të kontestimit gjurmë në dokumentacion kjo punë?

Z. F. Nuri: Faleminderit për pyetjen po e filloj unë përgjigjen dhe pastaj kandidati nëse ka diçka tjetër për të shtuar, në procesverbal nuk ndalemi vetëm tek qendra 2551, por edhe për qendrat e tjera për shëmbull për qendrën 2563/01, pikërisht IEVP “burgu Kosovës” është mbajtur shënim në procesverbal, se votimi thonë ka dyshime se vendimi është i diktuar duke patur parasysh mungesën e kamerave dhe të pajisjes PEI.

Z. I. Rusmali: Pyetja ime nuk ka lidhje me çfarë ka bërë KZAZ-ja në raport me votimin ka lidhje vetëm me numërimin dhe rivlersimin e votave, nëse po themi në vlersimin e përfaqësuesit tuaj një votë ka qenë e pavlefshme, ka qenë me shenjë dhe është konsideruar e vlefshme edhe është vënë në favor të kandidatit të PS-së. Vëzhguesi juaj e ka kontestuar? Ka ngritur dorën ka thënë sjam dakord me këtë? Është bërë procedura e kontestimit? Këto veprime janë kryer?

Z. B. Qypi: Patjetër që po, aty patjetër gjatë procesit ka patur debate nga vëzhguesit nga jashtë edhe kur vinin nuk po vendoste më komisioni po vendoste vëzhguesi nga jashtë, prova është e vlefshme sështë e vlefshme, edhe unë si kandidat isha gjatë gjithë procesit të numërimit, jamë drejtuar komisionit për

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

procesverbal më thanë nuk kemi kopje, gjatë gjithë procesit unë nuk kam marrë një kopje procesverbali.

Z. I. Rusmali: Të lutem mos mu largo nga pyetja se nuk më ndihmon fare më fut në kolaps, pyetja është kjo... kontestohet vlersimi për nga grupi i numërimit ngrihet dora, grupi i numërimit e rivlerson, grupi i numërimit e heq me një anë si të kontestuar, bëhet në fund fare rivlersimi dhe pastaj mblidhet KZAZ-ja bën vlersimin dhe shënimin tek fleta e votimit, shënimin çfarë është kontestuar dhe si është vlersuar, kjo procedurë që lë gjurmë në dokumentacion. Është kryer për këto vota që ju i konsideroni të vlersuara gabim?

Z. F. Nuri: Ne nuk kemi djeni që kjo procedurë të jetë zbatuar pikë për pikë siç e thoni ju, por ne kemi djeni dhe nga kandidati dhe nga përfaqësuesit tanë se aty ka patur debate ka patur kontestime për shëmbull, votimi me gërmën "a" apo me siglën PS, e të tjerë e të tjerë, që janë quajtur vota të vlefshme dhe që absolutisht në kundërshtim me procedurat e Kodit Zgjedhor na janë referuar përpara se të merreshin kamerat, kamerat ne pikërisht i kemi kërkuar kamerat në ato qendra votimi sepse aty kemi patur dyshime dhe kemi patur edhe kamerat dhe i evidentuam përsëri dhe patjetër që KAS-i nëse do të marrë vendimin për t'i parë për t'i vizionuar kamerat për të hapur kutitë në ato qendra e vërteta do të dali.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Nuri.

Z. I. Rusmali: Fleta e votimit, votimi me shenjë është i kundraligjshëm. Pse?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. F. Nuri: Në djetinë time vetëm dy shenja janë që lejohen të përdoren për të shprehur vullnetin votuesi, shenja kryq dhe shenja plus. Ndaj çdo shenjë tjetër do të lejonte identifikimin e votuesit.

Z. I. Rusmali: Shenja “a”. Si e identifikon votuesin?

Z. F. Nuri: E bënë të dallueshme, në momentin që numërohet.

Z. I. Rusmali: Shënja “a” është e ndrueshme nga shenja x. Si e identifikon votuesin?

Z. F. Nuri: Patjetër që mund ta bëjë të identifikueshëm në momentin që hapet kutia numërohen e të tjerë e të tjerë.

Z. I. Kaso: Nëse mund ta plotësoj, kemi patur raste të tjera ndoshta jo vetëm ne, në cilësinë e ankuesve, kur janë paraqitur pretendime jo gjithmonë të provuara përpara KAS-it dhe përpara KQZ-së, të zgjedhësve që shtrëngohen të votojnë përkundër atyre të cilët nuk lejohet të që të votojnë ditën e zgjedhjeve, kemi denoncime publike pafund të zgjedhësve të cilët shtrëngohen të votojnë por ju kontrollohet vota në një mënyrë të caktuar. Mënyra tradicionale dhe më e thjeshta e kontrollit të votës është që.. zgjedhësin të cilin e shtrëngon në një mënyrë të caktuar, e urdhëron e preson, e kërcënon nëse duam që të votojë në një mënyrë që të caktuar, i imponojmë dhe formën në të cilën duhet të votojë në mënyrë që të kemi garancinë edhe ne, por edhe ai i pari që të mos devijojë që vota i kontrollohet dhe.... vota e tij

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

është lehtësisht e indentifikueshme në procesin e numërimit, prandaj unë nëse do ta bëja një gjë të tillë, se kam bërë kurrë po nëse do të kisha hallin e madh ta bëja një gjë të tillë me një zgjedhës sigurisht do t'i kërkoja që votoni në një mënyrë nga të gjithë zgjedhësit e tjerë në mënyrë që kur të hapet kutia jote të mund ta dallojë votën tënde, me këtë simbol, me këtë shenjë, me këtë gjurmë që të jap unë, më parë janë përdorur stilolapsa të ndryshëm tani për fat të keq të procesit zgjedhor rafinimi ka kaluar fazën e stilolapsit me ngjyrë të ndryshme me atë të indentifikimit me një shkronjë të caktuar, me një simbol të caktuar, me një shenjë të caktuar dhe ky është shembulli klasik i shenjës që indentifikon qartë zgjedhësin në raport me atë çka i është inponuar të votojë ose i është kërcënuar ose i është premtuar të themi të votojë. Kemi patur raste, këtu kemi patur edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kur janë hapur kuti votimi kemi patur zgjedhës që në mënyrë krejt të pashpjegueshme vota grupe votash kanë qënë të markuara në një pozicion të caktuar të kutisë, kur kanë qënë ato kutitë e mëdha në të cilat votohej, voton cepin e djathtë se kështu ta kontrolloj votën, ose në mënyrë krejt të pashpjegueshme në një qendër të madhe më kujtohet, kanë qënë rreth 500 zgjedhës të cilët kishin votuar, por 10 zgjedhës me shumë gjasa të një familjeje kishin votuar me tre kryqe në qendrën e votimit në mënyrë që në rreshtë të raportoj në momentin që numërohej dhe tabulohej rezultati i asaj kutie, që të 10 pjestarët e asaj familjeje (hipotezë e imja) kishin votuar për atë që ju ishte thënë për të votuar, edhe kishin votuar për të njëjtin kandidat me atë shenjë indentifikuese, që vërtetonte që vota ishte e këtyre sipas premtimit që kishin dhënë ose sipas kërcënimit që kishin marrë, kështu që të paktën në këndvështrimin tonë si ankues kjo është rasti klasik i një personi që s'ka votuar i lirë dhe që është detyruar është shtrënguar që të prodhojë evidenca që ka votuar në një mënyrë të caktuar.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Rusmali: Mirë nëse mund ta kthejë pyetjen tek administrata e KQZ-së. Si është leximi i kësaj vote? Votës me shenjën “a” në manualet të trajnimit të KQZ-së? E bëni ju këtë shpjegim?

Z. Y. Merkaj: Në manualet e trajnimit bëjmë disa shenja siç është plusi, x dhe ndonjë shenjë tjetër dhe çdo shenjë e qartë, që tregon qartasi vullnetin e zgjedhësit. Nuk ka ndonjë shenjë të përcaktuar ose të kufizuar që duhet të jetë kështu, që zgjedhësi të ketë treguar qartë vullnetin e tij.

Z. L. Braho: Po keni ndonjë rregull se kur quhet vota e indentifikueshme? Se këtë kur shprehet vullneti e kuptuam, po kur vota mund të jetë e indentifikueshme. Nëse unë shkruaj emër mbiemër tek fleta e votimit?

Z. Y. Merkaj: Kjo është e palejueshme, nëse shkruan emër, mbiemër, firmën.

Z. L. Braho: Ka ndonjë lidhës shteruese apo shihet rast pas rasti?

Z. Y. Merkaj: Rast pas rasti, edhe janë bërë disa raste që janë bërë pa rregulla.

Z. L. Braho: Ka ndonjë kërkesë tjetër nga palët? Përpara se të vendosim në lidhje me një nga pikat e kërimit tuaj që ka të bëjë me rinumërim, vlersim të disa qëndrave të votimit. Keni ndonjë kërkesë tjetër?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

Z. I. Kaso: Sigurisht kemi kërkesë proceduriale në zbatim të dispozitave të cilët rregullojnë procesin e shqyrtimit në KAS, veçanërisht për sa i përket nenit 136, që rregullon pjesën e paraqitjes së pretendimeve dhe kërimit të provave, paragrafi 1, gërma “c” e të cilit parashikon se në përfundim të veprimeve të përcaktuara të nenit 135, kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KAS-i në këtë rast fton palët të paraqesin pretendimet e tyre, palët duhet të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet në rast se nuk ka qenë e mundur se këto prova siguroheshin paraprakisht prej këtyre duke paraqitur njëkohësisht dhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre dhe në rastin tonë krahas indicieve të cilat ne kemi mundur që të sigurojmë dhe provave për sa i përket pretendimit tonë tjetër, atij për shkelje të ligjit që ka ndodhur që në momentin e ngritjes të qendrës së IEVP-së Lushnje, edhe më pas rezultatet që ka prodhuar. Provat që lidhen me indicjet që ne paraqitëm për shkeljet e ligjit në procesin e numërimit të tabulimit janë vetë fletët e votimit të cilat gjenden në kutitë e votimit, përkatësisht në zarfin e votave të vlefshme për secilin kandidat dhe në zarfin e votave të pavlefshme të cilat kërkojnë... duke qenë se nuk janë në disponimin tonë pasi gjenden të mbyllura brenda kutive kërkojnë që të administrohen nga ne KAS-i, në cilësinë e provës në kuadër të shqyrtimit.

Z. L. Braho: Që të jemi më të qartë, ju keni sjellë këtu një listë me qendrat e votimit nga pretendime lidhur me vlersimin e votave nga ana e grupeve të numërimit dhe ju, kërkon nga KAS në zbatim të nenit 136 të Kodit Zgjedhor që këto kuti të këqyren nga KAS-i dhe këtu i përfshini të gjithë votat që janë për kandidatët për kryetar bashkie, pra jo vetëm ato që janë votat e vlefshme dhe votat

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

e pavlefshme, pra për të gjithë qendrat e votimit përkëto qendra votimi që ju, kërkonte.

Z. I. Kaso: Ne këto kemi mundur të evidentojmë por ne i kërkojmë në zbatim të një standarti që është vendosur që në zgjedhjet e vitit 2011, kur një proces rinumërimi dhe rivlersimi u quajt atëhere i votave, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesave për Bashkinë Tiranë, shtynë Kolegjin Zgjedhor që të merrte një vendim historik i cili me sa di unë është aplikuar në të gjitha rastet e mëpasshme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve por edhe nga vetë Kolegji Zgjedhor, që në kuadër të një hetimi administrativ ose kuazi gjuqësor në këtë rastin tuaj të thelluar, momentin që ka indicie të mjaftueshme ose vendoset në një farë mënyre hapja, këqyrja e materialit zgjedhor qoftë me cilësinë e provës qoftë për efekt të disponimeve të nenit 138 që kanë të bëjnë me këqyrjen e materialit zgjedhor, të mos hapi kutitë ose t'i administrojë këto prova në mënyrë selektive por t'i bëjë për gjithë zonën zgjedhore kështu që ne, në këtë kuadër e kërkojmë për të gjithë zonën zgjedhore pavarësisht se indiciet ose çfarë kemi mundur të vërejmë ne, në kohën e limituar që kemi patur, janë vetëm për ato qendra të cilat ju, keni në tabelë.

Z. L. Braho: Faleminderit, ndonjë kërkesë tjetër, po zoti Salianji.

Z. E. Salianji: Siç edhe gjatë parashtrimeve në nënshkrim që normalisht ku kërkesa për rinumërim dhe rivlersim ka një indicie ka një fillim prove, KAS-i duhet të shprehet që këtë me vendimarrje duke rinumëruar dhe rivlersuar por meqënëse pala tashmë i ka identifikuar ku janë këto fletë votimi, por thjeshtë për

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancë publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.05.2023*

efekt kohe nuk ja bënë me dije KAS-it, të fotografuara ose të printuara ne, kërkojmë se përpara se ju, të shpreheni për këtë vendim t'i lihet kohë ankimesit, një kohë e përshtatëshme sa ai do e kërkojë që t'i gjejë këto fletë votimi, t'i rigjej se i ka gjetur sipas parashtrimeve dhe të na i bëjë me dije pastaj ju të shpreheni për rinumërim ose rivlersim, faleminderit.

Z. E. Salianji: Po faleminderit zoti Salianji, atëherë KAS do të tërhiqet për vendim në lidhje me këtë kërkesë.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.30.05.2023

Rifillon Mbledhja

Ora 18:46

Z. L. Braho: Përshëndetje edhe njëherë. Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore të subjektit zgjedhor Koalicioni “ Bashkë Fitojmë” në lidhje me rezultatin e Bashkisë Belsh. KAS pasi u tërhoq për kërkesën e ankimuesit për rivlerësim dhe rinumërim të votave për kandidat për kryetar bashkie në një sër QV vendosi që ti lërë kohë subjektit ankimues Koalicionit “Bashkë Fitojmë” deri në ditën e Hënë për ti kqyrur të gjithë materialet filmike që kanë marrë në lidhje me numërimin e këtyre QV nga KZAZ-ja përkatëse dhe të paraqes si prova në formë fizike, të gjithë ato vota të cilat janë cituar në tabelën që paraqiti sot si vota që janë të diskutueshme në favor të njërit apo tjetrit subjekt. Në varësi të provave që do të sjelli do të vendoset edhe fakti në qoftë se do të pranohet kërkesa për rivlerësim dhe rinumërim të këtyre QV apo edhe QV të tjera të Bashkisë Belsh. Po ashtu KAS me shumicë votash në zbatim të nenit 137 të Kodit Zgjedhor do i kërkoj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informacion si më poshtë vijon: Informacion që do të kërkohet nga administrata e KQZ-së dhe që do të kthehet përgjigje deri ditën e Hënë. Për 22 zgjedhësit që kanë votuar në QV të burgut Lushnje. Pyetja e parë është kur janë dërguar këta persona për të vuajtur dënimin në IEVP Lushnje? A është dënim i që i takon për të vuajtur këtyre personave më i gjatë se tre muaj dhe a ndodhet ndonjë nga këto votues në kushtet e ndalimit për të votuar në kuptim të ligjit për dekriminalizimin? Këto përgjigje në bazë të nenit 137 i kërkojmë deri në ditën e Hënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kështu që KQZ të marrë masa që ta dërgojë shkresën sa më shpejt. Në këto kushte duke qenë se jemi në proces për marrjen e provave do ta pezullojmë shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore dhe do të vijoj ditën e Hënë në ora 12 e 30. Seancën e deklarojmë të mbyllur për sot.

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI

